



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 244/2017

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 21/04/2017 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Modifikimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me objekt “*Rikonstruksion dhe shtrim i rruges bujqesore te fushes se fshatit Pal*” me nr. Ref 71229-03-09-2017 me fond limit 76,573,764 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 31.03.2017 nga autoriteti kontraktor Bashkia Sarandë.

Ankimues:

“Mane/S ” sh.p.k.
Adresa: Lagjia Nr.2 Pallati nr, 46
Sarandë

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Sarandë
Adresa: Rruga “Abedin Dino”, Lagjia nr 1,
Sarandë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë

17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, i cili nuk e ka pranuar atë, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II. Në datën 09.03.2017 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur” me objekt “Rikonstruksion dhe shtrim i rruges bujqesore te fushes se fshatit Pal” me nr. Ref 71229-03-09-2017 me fond limit 76,573,764 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 31.03.2017 nga autoriteti kontraktor Bashkia Sarande.

II.1 Në datën 15.03.2017 pala ankimuese “Mane/S” sh.p.k. ka dorëzuar ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar kriteret e veçanta të kualifikimit për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.1.1 Në ankesën drejtuar autoritetit kontraktor pala ankimuese kundërshton kriteret e veçanta të kualifikimit dhe specifikimet teknike të procedurës së mësipërme të prokurimit. Në mënyrë të përmbledhur pala ankimuese ngren pretendimet se:

[...]Nga ana e Autoritetit Kontraktor Bashkia Sarande është publikuar ne faqen e internetit te APP -se ne date 10/03/2017, procedura e prokurimit e hapur-punë me objektin sa më lart. Shoqëria jone ndërtimore, është e interesuar te marre pjese ne ketë procedurë prokurimi, ndaj mbështetur ne te drejtën qe i njeh ligji parashtrijmë para jush ankesën tone lidhur me kriteret për kualifikim te vendosura nga ana juaj. Pasi morën ne shqyrtim kriteret e veçanta për kualifikim te vendosura nga ana juaj, konstatojmë se disa nga këto kriteret janë vendosur ne kundërshtim me parashikimet ligjore. Sa me poshtë parashtrijmë ankesën tone për kërkesat te cilat janë vendosur ne kundërshtim me kërkesat ligjore:

i. Te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, "Kapaciteti teknik", pika 2, është kërkuar ne kundërshtim te hapur me parashikimin ligjor: a. License profesionale e Shoqërisë e vlefshme me kategoritë: • NP-12C(Punime te inxhinierisë se Mjedisit)• NS- I 8C (Punime Top gjeodezikë). Pasi analizuam me kujdes projektin, preventivin dhe specifikimet teknike të publikuara ne APP për ketë objekt tenderi, konstatojmë se vlera e fondit limit e objektit është 76,573,764 Leke dhe zërat e punimeve te përcaktuara në preventiv konsistojnë në :-gërmim me makineri dhe me krahë dhe transport,-skarifik skarpate, -shtese cakelli, stabilizante dhe binderi,-tombino me tuba, -kemishe betoni, - furnizim vendosje të 20 fidaneve. . Mbështetur ne vendimit nr. 42, date 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies se licencave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike, qe ushtrojnë veprimtari ndërtimi", pikat e licencës dhe kategoritë me klasifikimet përkatëse caktohen duke u mbështetur ne punimet e parashikuara ne preventivin e objektit dhe ne vlerën totale te punimeve për secilën kategori. Ne Lidhjen nr.2 te këtij vendimi përcaktohet se pikat: NP-12(Punime te inxhinierisë se Mjedisit) përmbledh: konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose rikonstruktime te veprave dhe punimeve te veçanta ose te shpërndara ne territor dhe vlerësimit te kompaktësimit te zhvillimit te qëndrueshëm te ekosistemit, përfshire te gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik. Përfshinë në mënyre të thjeshtuar procesin e riaftësimit natyror, botanik, aforistik, konservimin dhe riaftësimin e terrenit te përdorur për karriera gurore dhe te baseneve hidrografie, eliminimin e prishjes se ekuilibrave hidrogeologjik nëpërmjet kthimit ne toke buke, te veprave për stabilizimin e shpateve dhe ripyllëzimeve te punimeve te sistemit bujqësore dhe te veprave për rivegjetizimin e rrugore, hekurudhore dhe karrierave dhe mbetjeve inerte. Siç rezulton NP-12 mund të kërkohet vetëm kur në preventivin e objektit, janë parashikuar punime qe përmbledh kjo pikë, siç edhe i parashtruam më lart dhe në asnjë rast tjetër që nuk përfshihet këtu nuk mund të kërkohet një pike e tillë. Po të rikthehemi te punimet e përcaktuara ne preventivin e objektit nuk gjejmë asnjë zë punimi qe te përputhet me punimet qe përmbledhë NP- I 2. Nga ana tjetër po të marrim në analize klasifikimin C, të cilin e kërkon për ketë pike, referuar Lidhjes Nr.4, klasifikimi C përmbledh sipas vlerave ne lek punime te te njëjtës kategori, nga 50- 100 mi lion

lekë. Pra në kushtet kur gjithë vlera e objektit është 76,573,764 Leke, është e pamundur dhe jashtë çdo justifikimi kërkesa juaj që operatori ekonomik duhet të disponojë licence: • NP-12C(Punime te inxhinierisë se Mjedisit). Në kushtet, kur ky kriter është vendosur në kundërshtim me parashikimet ligjore kërkojmë heqjen e kësaj kërkesë ose modifikimin e këtij kriteri duke kërkuar si kriter NP-12 A(Punime te inxhinierisë se Mjedisit), pra klasifikimin minimal. Gjithashtu ju kërkon NS-18 C (Punime Top gjeodezikë), ndërkohë që në Lidhjen Nr.2 të vendimit nr. 42, datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies se licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", përcaktohet se NS -18Ju sjellim në vëmendje që përveç këtyre dy pikave të licencës që ne kundërshtuam me lart autoritet juaj ka kërkuar edhe dy pika të tjera me klasifikim C dhe një pike me klasifikim B, pra duke konsideruar se volumet me të mëdha të punimeve janë të përqendruar në punimet që përfshihen në pikën : • NP-IC (Punime gjurmimi tokë); • NP-4C (Rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai metro, pista aeroportuale) • NP-5B (Punime nëntokesore, ura dhe vepra arti) . Në këto kushte kriteret tuaj për NP- I 2 C (Punime të inxhinierisë se Mjedisit) dhe NS- 18 C (Punime Top gjeodezikë) janë në kundërshtim me kërkesat ligjore. Edhe pse nuk jeni shprehur sakte edhe ju vete jeni të qartë që volumi me i madhe i punimeve përqendrohet në punimet NP- I dhe NP-4 pasi ju shpreheni Pikat e licencës kategoria C kemi të bëjmë me një projekt rrugë ku punimet e gjurmimit zënë presupozoni volumin më të madh të punimeve. Pra sipas kategorive të punimeve që ju keni kërkuar në tender duhet që objekti ta kishte fondin limit 225 000 000 lekë gati 3 herë më shumë se fondi limit që ju keni shpallur për prokurim me vlerë 76,573,764, pra duket hapur që kategoritë e kërkuara nga ana juaj janë në shkelje të ligjit.

ii. Te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, "Kapaciteti teknik", pika 2.1, është kërkuar në kundërshtim të hapur me parashikimin ligjor: 2.1 Mbështetur në natyrën e punimeve të parashikuara në projekt-preventiv, duhet që operatori ekonomik të disponojë licencat e nevojshme (lëshuar nga QKL). Për këtë duhet të paraqesin licencat: -Licence lidhur me ndikimin në mjedis të lëshuar nga QKL. Kodi III.2.A. Të nderuar ju bëjmë me dije se në bazë të ligjit Nr. 10440, data 7.7.2011 PER VLERESIMIN E NDIKIMIT NE MJEDIS, Kreu 2, neni 7, VNM duhet të hartohet nga ekspertët licencuar dhe të pavarur, të pajisur me licence QKL Kodi 111.2.A, përpara dhënies se lejes nga autoriteti përgjegjës për zhvillimin ose jo të projektit. Gjithashtu referuar nenit 1 të po këtij ligji parashikohet se: Ky ligj ka për qëllim të sigurojë: a) një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, përmes parandalimit, minimizimit dhe kompensimit të dëmeve në mjedis, nga projekte të propozuara që përpara miratimit të tyre për zhvillim. Autoriteti kontraktor në rastet kur nuk ka ekspertet e vet të licencuar për VNM, duhet të kontraktojë një ekspert të pavarur i cili është i licencuar dhe i pajisur me Licence lidhur me ndikimin në mjedis të lëshuar nga QKL. Kodi 111.2.A, i cili duhet të jetë subjekt i pavarur dhe kurrsesi i lidhur me sipërmarrësin e punimeve. Në këto kushte kur ligji

ngarkon autoritetin kontraktor të hartojë VNM, për projektet e propozuara që përpara miratimit të tyre për prokurim kërkesa juaj që Operatori Ekonomik, pjesëmarrës në tender për zbatimin e punimeve të projektit të miratuar, duhet të disponojë Licence lidhur me ndikimin në mjedis të lëshuar nga QKL. Kodi 111.2.A, është në kundërshtim të ligjit. Sipërmarrësi nuk mundet kurrësi të beje studimin e ndikimit në mjedis VNM, për projektin që zbaton pasi ligji e ndalon këtë gjë, por për me tepër ka konflikt interesi pasi nuk mund të kontrollojë vetveten. Gjithashtu referuar VKM 354 datë 11.05.2016, fazat nëpër të cilat kalon miratimi një projekti përpara se të kalojë për tenderim janë këto: Tipologjitë e shërbimit të përcaktuara në këtë manual janë të ndara sipas fazave 1-9 paraqitur më poshtë: FAZA I: Analiza e detyrës së projektimit/termat e referencës dhe përcaktimi i bazës së projektit; FAZA II: Projekt ideja paraprake; FAZA III: Projekt ideja përfundimtare; FAZA IV: Projekti për miratimin e lejes së ndërtimit; FAZA V: Projekti i zbatimit; FAZA VI: Preventivi përfundimtar; FAZA VII: Përgatitja e dokumentacionit për procedurë tenderimi; FAZA VIII: Mbikëqyrje; FAZA IX: Përgatitja e dokumentacionit përfundimtar për kolaudim. Pra përpara se projekti të kalojë për tenderim duhet të ketë kaluar nga faza 1-6 pra duhet të jetë hartuar i gjithë dokumentacioni për miratimin e lejes së ndërtimit ku përfshihet edhe VNM-ja si pjesë e detyrueshme për aplikim për leje. Ky detyrim për përgatitjen e këtij dokumentacioni takon autoritetin kontraktues. Ky detyrim parashikohet edhe në VMK nr.13 datë 04.01.2014. Në këtë kushte kërkojmë heqjen e këtij kriteri të vendosur në kundërshtim të hapur me kërkesat Ligjore që parashtruan më lart, por edhe në kundërshtim të hapur me kërkesat e nenit 26 të VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Rregullat e prokurimit Publik" i ndryshuar dhe nenin 46 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, "Ligjit të Prokurimit Publik" i ndryshuar, ku parashikohen në mënyrë shteruese kriteret që mund të kërkojë autoriteti kontraktor.

iii. Te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, "Kapaciteti teknik", pika 11, është kërkuar në kundërshtim të hapur me parashikimin Ligjor: Certificate Sistemin e administrimit të sigurisë së informacionit (ISO 27001 -2005 e vlefshme)/ Kjo kërkesë është në kundërshtim të hapur me kërkesat e parashikuara në nenin 46 të LPP dhe nenin 26, të VKM 914 datë 29.12.2014. Sipas kërkesave ligjore të parashikuara në Ligjin e Prokurimit Publik Nr. 9643 datë 20.11.2006 i ndryshuar, kërkesa juaja presë i përket certifikatës të kërkuar, konkretisht ISO 27001 :2005, është e pambështetshme pasi karakteristika e kësaj ISO, nuk kanë të bëjnë aspak me objektin e prokurimit.

iv. Në "Kapacitetin teknik", pika 4, është kërkuar në kundërshtim të hapur me kërkesat ligjore: Një punësim mesatar i të paktën 120 (njëqind e pesëdhjetë ???) personave, për periudhën Shkurt 2015 -Shkurt 2017 të vërtetuar me;

i. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; për periudhën Shkurt 2015 -Shkurt 2017. ii. Listë pagesat e punonjësve për periudhën Shkurt 2015 -Shkurt 2017 të konfirmuar nga Administrata Tatimore shoqëruar këto dhe me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore e shëndetësore TAP, urdhër xhirime në të cilët duhet të jenë të përfshirë dhe Staf i teknik të

mëposhtmen: 2(dy) inxhinier Ndërtimi; 2(dy) inxhinier Gjeodet; 1 (një) inxhinier Hidroteknik; • 1 (një) inxhinier Elektrik; 1 (një) inxhinier Mekanik; 1 (një) inxhinier Mjedisi; • 1 (një) inxhinier Gjeolog 1 (një) inxhinier Agronom

Se pari: Ky kriter është tepër i ekzagjeruar dhe nuk ka asnjë mbështetje ligjore, pasi po t'i referohemi kërkesave të nenit 26, pika 8, germa b, e VKM 914, përkatësisht: "dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit" dhe në nenin 46 të LPP ku parashikohet: "aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asketë të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktues në njoftimin e objektit të kontratës", është evidente që kjo kërkesë është shumë e tepruar, pasi janë kërkuar një numër shumë i madhe prej 120 punonjës, për dy vitet e fundit. Nga analiza e zërave të punimeve dhe analiza për orët e punës që duhen për realizimin e këtij objekti, me një thotë të ti lie mjetesh siç dhe ju keni kërkuar dhe për një afat realizmi kontrate dy muaj, rezulton se për përfundimin e këtij objekti janë të mjaftueshëm maksimumi 80 punonjës. Gjithashtu kërkesa juaj për të paraqitur përveç Vërtetimit të lëshuar nga Administrata Tatimore edhe listat e pagesave të konfirmuara nga tatimet, edhe formularët e deklaratimit të pagesave për sigurimet shoqërore e shëndetësore TAP dhe urdhër xhirime në të cilët duhet të jenë të përfshirë dhe Stafit teknik, është një kërkesë diskriminuese, totalitë e panevojshme dhe me karakter pengues, që vjen ndesh me kërkesat e nenit 26 të VKM 914 datë 29.12.2014 dhe nenin 46 të LPP, ku është rëndësishme të tregohet që OE disponon fuqinë punëtore të nevojshme dhe jo të kontrollohet nëse disponohen nga operatori ekonomik TAP dhe Urdhër Xhirimet për listat e pagesave. Kjo i takon institucioneve të posaçme të bëjnë verifikimin nëse janë realizuar ose jo listat nëpërmjet urdhër xhirimeve dhe presa kohe Organet Tatimore, që janë edhe organet kompetente për kontrollin e këtyre veprimeve, lëshojnë Vërtetim për numrin e punonjësve për çdo muaj, e shoqëruar kjo edhe me listat e konfirmuara prej tyre, kërkesa juaj për të paraqitur TAP dhe Urdhër xhirimet për çdo muaj është të tejkalim të të gjitha dispozitave ligjore që rregullojnë procedurat e prokurimit. Për këtë arsye kërkojmë të hiqen nga kriteret kërkesa për të paraqitur edhe formularët e deklaratimit të pagesave për sigurimet shoqërore e shëndetësore TAP dhe urdhër xhirimet ku duhet të jenë të përfshirë dhe Stafit Teknik. Së dyti, kërkojmë nga ana juaj ndryshimin e kriterit për një punësim mesatar i të paktën 120 (njëqind e pesëdhjetë) personave, për periudhën Shkurt 2015 -Shkurt 2017, duke kërkuar përfundimisht një punësim mesatar i të paktën 80 (tetëdhjetë) personave, për periudhën Shkurt 2016 -Shkurt 2017. Kërkesa jone gjë mbështetje në përllogaritjen e që kemi bërë për fuqinë punëtore të nevojshme për realizimin e këtij objekti, në raport me orët e punës, volumet e punimeve dhe makineri pajisjet që kërkojnë nga ana juaj. Po ashtu kriteri i vendosur për një numër mesatar prej 120 punonjësish, për dy vitet e fundit

është i tepruar dhe nuk është në koherence me frymen e ligjit pasi kërkesat e nenit 26, pika 8, germa b, e VKM 914 date 29.12.2014 kanë si qëllimi krijimin e një panorame të përgjithshme për kapacitetet teknike të OE, për ekzekutimin e kontratës në momentin që flasim dhe jo për periudhen para dy vjetesh. Pra nuk është e nevojshme që të kërkohe lispagesat për vitin 2015, për faktin se ligji parashikon që OE duhet të zoterojë kapacitetet teknike në momentin e ofertimit dhe jo para 2 viteve. Në këto kushte autoriteti për të vlerësuar kapacitetet, reputacionin dhe besueshmerinë i duhet më tepër gjendja në fakt pra në momentin e ofertimit, sesa kapacitetet e para disa viteve të cilat në vetvete nuk tregojnë asgjë. Nisur nga sa më lart, kërkojmë heqjen e këtij kriteri diskriminues dhe AK të modifikojë këtë kërkesë duke kërkuar lispagesat e 12 muajve të fundit. Së treti, kërkesat tuaja për një staf teknik prej :

- 2(dy) inxhinier Ndërtimi;
- 2(dy) inxhinier Gjeodet;
- 1 (një) inxhinier Hidroteknik;
- 1 (një) inxhinier Elektrik;
- 1 (një) inxhinier Mekanik;
- 1 (një) inxhinier Mjedisi;
- 1 (një) inxhinier Gjeolog;
- 1 (një) inxhinier Agronom.

Janë tepër të ekzagjeruar dhe disa prej inxhinjereve që kerkoni të jenë në staf teknik nuk mbështeten në pikat e licensave të kërkuara dhe me punimet që parashikon preventivi. Pra nga ana juaj kërkohe dy inxhinier gjeodet nderkohe që në analizë të punimeve që parashikohen të kryhen në baze preventivi, nuk rezultojnë që të ketë fare punime që të justifikojnë punën e dy inxhinierëve. Sic edhe sqaruar në pikën 1 të kësaj ankese në këtë objekt nuk ka punime që të justifikojnë kërkesat për pike license NS-18, e cila mbulohet nga inxhinier gjeodet. Në këto kushte kërkojmë të hiqet kërkesa për 2 inxhinier gjeodet, pasi ajo nuk gjen mbështetje ligjore dhe nuk ka punime në preventiv që të justifikojnë këtë kërkesë për këtë numër të konsiderueshëm inxhinieresh. Gjithashtu nga ana juaj kërkohe, një inxhinier Mekanik i cili mbulon punimet e parashikuara nga pikat e licensës NS -3 dhe NS-12, pra punime mekanike. Sic edhe ju vetë jeni koshient që nuk është e nevojshme inxhinier mekanik, pasi nuk keni kërkuar që OE të ketë license për pikat NS -3 dhe NS-12, edhe nga ana juaj vërehet se në zërat e punimeve të parashikuara në preventiv, nuk ka asnjë zë që të justifikojë këtë kërkesë. Kështu që në zbatim të kërkesave ligjore të Vendimit nr.42, date 16.01.2008 dhe nenit 46 të LPP kërkojmë heqjen e këtij kriteri pasi kërkesa për një inxhinier mekanik nuk gjen mbështetje ligjore. Po ashtu në kriteret e vendosura nga ana juaj kërkohe një inxhinier Gjeolog, i cili referuar Vendimit nr.42, date 16.01.2008 mbulon punimet e parashikuara nga pika NS-20, pike të cilën ju nuk e kerkoni pasi nuk ka punime në preventiv që të justifikojnë këtë pikë license. Në këto kushte kur kërkesa për një inxhinier Gjeolog nuk gjen mbështetje as në punime të parashikuara në preventiv dhe as në pikat e licensave të kërkuara nga ana juaj kërkojmë që në zbatim të ligjit të hiqet ky kriter. Gjithashtu nga ana juaj kërkohe një inxhinier Agronom, kërkesë e cila nuk gjen asnjë mbështetje as në zërat e parashikuara në preventiv e as në pikat e licensave që ju keni kërkuar. Ju sjellim në vëmendje që në preventivin e këtij objekti keni parashikuar mbjelljen e 20 copë fidane pemë dekorative, të cilat do të jenë furnizim vendosje, pra këto fidane do të furnizohen nga subjekte të licensuara për rritjen dhe kultivimin e fidaneve dhe nuk do të kultivohen nga sipërmarrësi

i punimeve. Nuk e kuptojme ku konsiston puna e inxhinierit agronom në zbatimin e këtij projekti. Po ashtu referuar edhe specifikimeve teknike të publikuara nga ana juaj, pika 5 nuk kërkohet detyrimisht që procesi i gjelberimit të ndiqet nga një agronom, por është paraparë mundësia për të kontaktuar një specialist që do të japë instruksionet e duhura. Pra kërkesa juaj për një drejtues teknik në license inxhinier Agronom është diskriminuese, në tejkalim të çdo parashikimi ligjor i pambështetur në punimet e kerkuara dhe me qëllim diskriminim dhe shmangien e garës. ..Omissis.... Në kushtet kur ligji në këtë tabelë, ka parashikuar gjithë inxhinieret që nevojiten për zbatim punimesh duke përfshirë gjitha punimet e zbatimit, që nga ngulja e një gozhde deri te mbjellja e një peme dhe në asnjë pikë të kësaj liste, ligji nuk ka parashikuar që për zbatim punimesh të kërkohet inxhinier Agronom. Në këto kushte nuk e kuptojmë ku e gjeni ju të drejtën për të kërkuar inxhinier agronom dhe gjithashtu nuk e kuptojmë ku e mbështesni këtë kërkesë absurde. Gjithashtu nga kontaktet tona me punonjësit e MTI sektori i licensave në zbatim mbasi na dha formularin e mesipër e mohoi kategorikisht Inxhinierin Agronom si drejtues teknik. Gjithashtu edhe ju vet, në specifikimet teknike pranonin se nuk është e nevojshme prezenca e një agronomi, por kontaktimi dhe konsultimi me një specialist, e konsiderojmë këtë kriter të vendosur në kundërshtim me ligjin, totalisht të panevojshëm dhe të pajustificuar, ndaj kërkojmë heqjen e këtij kriteri nga kërkesat për kualifikim. Ju kujtojmë këtu se kemi të bëjmë me rikonstruksionin e një rruge ekzistuese dhe jo me ndërtimin e një sere me domate apo patate!? Së katërti, përse i përket kërkesave tuaja që:

Operatori ekonomik duhet të ketë në licencën e shoqërisë drejtuesit teknik:

1 (dy) inxhinier Ndërtimi; 1 (dy) inxhinier Gjeodet; 1 (një) inxhinier Hidroteknik; 1 (një) inxhinier Elektrik; 1 (një) inxhinier Mekanik; 1 (një) inxhinier Mjedis; 1 (një) inxhinier Gjeolog; 1 (një) inxhinier Agronom për të vërtetuar plotësisht në këtë kriteri, Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin diplomat, kontratat e punës dhe CV përkatëse. librezat e punës. Drejtuesit teknik duhet të jenë të përfshirë në listat për periudhën Shkurt 2015- Shkurt 2017. Drejtuesit Teknik duhet të jenë me një përvojë pune minimumi 5 vjeçare. Kërkojmë që për të gjitha arsyet dhe për argumentat që dhënë me lart të hiqen kërkesat për një inxhinier Gjeodet, një inxhinier Mekanik, një inxhinier Gjeolog dhe një inxhinier Agronom, pasi janë kritere diskriminuese, nuk mbështeten në zërat e preventivit të objektit, nuk mbështeten me pikë license të kerkuara nga ana juaj në pikën 2 të kriterëve teknike dhe janë të vendosura në kundërshtim me ligjin. Gjithashtu kërkesa juaj që drejtuesit teknik duhet të jenë të përfshirë në listat për periudhën Shkurt 2015- Shkurt 2017, është në kundërshtim me parashikimet e Vendimit nr.42, datë 16.01.2008, kreu VI, ku parashikohet që marrëdhëniet e drejtuesit teknik dhe drejtuesit ligjor të shoqërisë rregullohen me kontratë pune e cila mund të jetë me afat të përcaktuar apo të papërcaktuar. Përse kohë kontrata e punës nënshkruhet nga dy palë drejtuesi ligjor dhe drejtuesi teknik, marrëdhëniet e punës rregullohen në Kodi i Punës së RSH. Mbështetur në nenin 143 e vijues të Kodit të Punës kontrata e punës mund të zgjidhet në çdo kohë duke respektuar afatet ligjore të njoftimit për nderprerje të marrëdhënieve të punës. Në këtë kontekst kërkesa juaj që këta drejtues teknik

duhet të jenë të pasqyruar në listpagesat për gjithë periudhën Shkurt 2015- Shkurt 2017 është në kundërshtim të hapur me përcaktimet ligjore që përmenden me lart,Në zbatim të këtyre dispozitave kërkojmë modifikimin e këtij kriteri, duke kërkuar vetëm që drejtuesit teknik të shoqërisë duhet të jenë të përfshirë në listpagesat e shoqërisë (pra ligjorisht mund të kërkojnë të pasqyrohen në listpages nga data e nënshkrimit të kontratës së punës).

v. Në "Kapacitetin teknik", pika 4, iv, është kërkuar në kundërshtim të hapur me kërkesat ligjore: iv. Të ketë në staf le punësuar dhe të figurojnë në listpagesa për periudhën e kërkuar me eksperiencë mbi 15- vjet një inxhinier mjedisi, të paraqitet diploma, kontrata e punës, CV, librezat e punës, certifikata e specialistit lëshuar nga Ministria e Mjedisit. (Kjo pikë shkon paralelisht me pikën 2.1 le kriterëve, pasi që një operator të marrë licencë nga QKL III.2.A duhet të ketë në mënyrë të domosdoshme inxhinier mjedisi me një eksperiencë 15 vjeçare dhe të ketë certifikata e specialistit lëshuar nga Ministria e Mjedisit).

Përsa i përket kësaj pike, ku kerkoni inxhinier mjedisi të pajisur me QKL 111.2.A me eksperiencë pune 15 vjet, për të gjitha arsyet që parashtruan me lart, ku kundërshtojmë kërkesën tuaj të parashikuar në pikën 2.1 të kriterëve teknikë, sqarojmë që kjo kërkesë është totalisht diskriminuese dhe ka për qëllim shmangien e garës për të favorizuar vetëm shoqëritë që kanë inxhinier mjedisi me eksperiencë pune mbi 15 vjet, që praktikisht i bie të jenë pedagogë të inxhinierisë së mjedisit. Një kërkesë e tillë është në kundërshtim me dispozitat ligjore pasi kjo lloj license kërkohej vetëm për ekspertet e mjedisit që bëjnë VNM, vlerësim i cili në këtë rast behet përparë miratimit të projektit dhe përparë aplikimit për leje ndërtimi, detyrim të cilin ligji ja ka ngarkuar autoritetit kontraktor, sic edhe parashikohet shumë qartë në ligjin Nr. 10 440, datë 7.7.2011 PËR VLERESIMIN E NDIKIMIT NE MJEDIS. Në këto kushte kërkesa juaj është vendosur në kundërshtim me parashikimet ligjore ndaj kërkojmë heqjen e këtij kriteri totalisht diskriminues e të pajustificuar.

vi. Në "Kapacitetin teknik", pika 4, v, është kërkuar në kundërshtim të hapur me kërkesat ligjore: v. Të ketë në stafin e tij për realizimin e kontratës, dy teknik topograf, një teknik mekanik, një teknik hidraulik të shoqëruar me dëftesat (diplomat) profesionale dhe kontratat e punës dhe të jenë të regjistruar në kompaninë e tij të figurojnë në listpagesa.

Kjo kërkesë është totalisht në kundërshtim me parashikimet ligjore, për të gjitha arsyet që parashtruan në pikën 4 të ankesës tonë, përsa i përket inxhinierit gjeodet (topograf) dhe inxhinier mekanik, pasi në preventivin e objektit nuk parashikohen punime që përmbledh pika NS-3 dhe NS-12 edhe punimet të NS-18. Ky projekt-preventiv nuk përfshin punime që të justifikojnë kërkesat për topogjeodezike dhe mekanik dhe në këto kushte nuk mund të legjitimohet as kërkesa juaj për teknik topograf, teknik hidraulik dhe teknik mekanik. Për më tepër që në VKM nr. 627 datë 11.06.2009 "Për miratimin e Listës Kombëtare të Profesionëve, profesionet që ju kerkoni nuk janë të parashikuara në këtë listë. Këto kualifikime, diploma, dëftesa janë dhënë përpara viteve 90, diploma të cilat nuk lëshohem

më prej shumë vitesh. Përsa kohe ju kerkoni një numer kaq të madh inxhinieresh kërkesa juaj për teknik është e tepërt dhe e panevojshme.

vii. Në "Kapacitetin teknik", pika 4, është kërkuar në kundërshtim të hapur me kërkesat ligjore: Të kete në stafin e punonjesve të pasqyruar në listepagesa të pakten 30 (tridhjetë) punonjës të pajisur me kartelat personale të sigurimit teknik, të leshuara nga organe kompetente të akredituara në bazë të ligjit nr. 8734, date 01.02.2001 dhe ligjit Nr.13/2013, date 14.02.2013, ku të përfshihen elektrikiste, hidraulike, mekanik, saldator). (zhvillimi i punes ka të domosdoshme praninë e punonjesve të kualifikuar në 120 punonjes duhet të jenë të paktën 30 specialist). Ju sjellim ne vemendje se akreditimet qe behen ne baze te ligjit nr. 8734, date 01.02.2001 dhe ligjit Nr.13/2013, date 14.02.2013, dhe kartelat e sigurimit teknik që lëshohen në bazë të këtij ligji, konsistojnë në certifikime për punonjës që do të punojnë në impjante, pajisje dhe instalime elektrike. Edhe vetë testimi që realizohet nga komisioni në baze të këtij ligji bëhet vetëm për punonjes elektrik, të cilët do të punojnë në tension në impjante, pajisje dhe instalime elektrike. Në kushtet kur në preventivin e këtij objekti nuk është parashikuar asnjë punim elektrik një kërkesë e tillë është e papranueshme.

viii. Në "Kapacitetin teknik", pika 4, vi, është kërkuar në kundërshtim të hapur me kërkesat ligjore: vi. Për gjithë drejtuesit e makinerive të renda, sipas Urdhër Nr.44, date 4.2.2004 "Për miratimin e rregullores "Për Procedural dhe kriteret për dhenien e lejeve të manovrimit përdoruesve të makinerive të renda të ndërtimit dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit" Dëshmi të aftësisë profesionale ose leje manovrimi të vlefshme lëshuar nga Ministria e Transportit dhe Infrastruktura të vlefshme, minimumi 5 automakinista, 1 eskavatorist me zinxhir, 2 eskavatorist me goma, 2 buldozerist të shoqëruar me kontratat e punës dhe të figurojnë në listpagesa.

Së pari ju bëjmë me dije se urdhëri nr.44 date dt 1.02.2004 është shfuqizuar me Urdhër nr. 47, date 29.3.2010 i cili, është shfuqizuar me urdhërin nr. 109 datë 05.08.2013, pra kërkesa juaj nuk gjen mbështetje pasi i referohet një urdhëri i cili është shfuqizuar. Referuar urdhërit në fuqi, përkatesisht nenit 7, pika c, specifikohet se: I. Makineritë e rënda të ndërtimit dhe emëtimet bëhen sipas dëshmive të aftësive profesionale (OAP), të cilat ndahen si me poshte: c) makineri ndërtimi mbi baze automjeti: autovinca, autobetoniere, autobetonpompa, autobitumatrine, autosonda, manovratoreve u jepet deshrni për automakinistë. Nga lista e makineri pajisjeve që ju keni kërkuar në piken 12 të kriterëve të vecakta rezulton se ju kerkoni një Autobetoniere dhe një Autopompe, nderkohe qe ne piken 4 (vi) te kriterëve teknike kerkoni minimumi 5 automakinista, kerkese kjo që nuk justifikohen në asnjë lloje mënyre. Kërkojme ndryshimin e këtij kriteri duke kërkuar vetëm një automakinist i cili për shkak edhe të procesit të punes që realizojnë këto dy mjete që ju keni kërkuar, mund të manovrohen nga i njëjti manovrator, pasi ato nuk punojnë të dyja në të njëjtën kohe. Kujtojmë ketu që autobetonieri dhe autopresa mund të levizi edhe me shofer i cili është i pajisur me patente tipi C. Pra në këto kushte nuk mund të kerkoni asnjë automakinist, i cili lidhet drejperdrejte me

mjetet që ju keni kërkuar, ndaj kërkojme ndryshimin e këtij kriteri. Së dyti referuar urdhërit në fuqi, përkatesisht nenit 7, pika a, specifikohet se: I .Makinerite e rënda të ndërtimit dhe emërtirnet bëhen sipas dëshmimeve të aftësive profesionale (OAP), të cilat ndahen si më poshtë: a) makineri gjërmirni e ngarkimi dherash: vetëshkarkues, ngarkues-transportues, ekskavatore, fadroma, ekskavatore të kombinuar me pajisje shtesë, lopata ngarkuese (me goma dhe me zinxhirë), manovratoreve u jepet dëshmi për ekskavatoriste (për mjete me goma ose me zinxhirë); Një eskavator ligjerisht mund të manovroje si mjetet me goma dhe ato me zinxhirë pa kufizim, nisur edhe nga fakti që mjetet që janë kërkuar nga ana juaj për këtë kategori, janë në një numër minimal dhe teknikisht nuk mund të punonjnë njëkohësisht në të njëjtën kohë në kantier, ndaj kërkojme ndryshimin e këtij kriteri duke kërkuar përfundimisht vetëm 2 ekskavatoristë. Së treti referuar urdhërit në fuqi, përkatesisht nenit 7, pika b, specifikohet se: I .Makineritë e rënda të ndërtimit dhe emërtimet bëhen sipas dëshmimeve të aftësive profesionale (OAP), të cilat ndahen si më poshtë: b) makineri gjërrnimi, shtyrje, nivelimi e ngjeshje dherash apo shpim toke: buldozere, traktore, skreper, greidera (niveles), rulo vibruet, shtruese asfalto-betoni, sonda shpimi vetelevizuese, manovratoreve u jepet dëshmi për buldozeriste (me goma ose me zinxhirë); Nga ana juaj kërkohen 2 buldozerist, në kushte kur në listen e mjeteve të kërkuara nga ana juaj, mjetet e kësaj kategorie janë 0, pra nuk është kërkuar asnjë buldozier të shtojca e makinerive. Në këto kushte kërkojme modifikimin e këtij kriteri duke mos kërkuar asnjë buldozeriste. Së katërti, referuar pikës 12 të kriterëve teknike (lista e mjeteve dhe pajisjeve) ju keni paraparë mundësinë e marrjes me qira të këtyre mjeteve, nepermjet kontratave të qirase, por nga ana tjetër në mënyrë absurde kërkon që, eskavatorist, buldozeriste dhe automakiniste, të shoqëruar me kontratat e punës dhe të figurojnë në listëpagesa. Të nderuar, në kushtet kur OE mund të marrë me qira automjetet, nuk mund të detyrohet që manovratorët për këto mjete të ketë detyrimisht me kontratë pune dhe të pasqyruar në listëpagesa, për më tepër që në rastin e marrjes me qira të mjetit mund të kontraktuje me kontratë shërbimi edhe manovratorët të cilët janë profesione të lira. Kërkojmë modifikimin e këtij kriteri duke lejuar edhe kontraktimin e shërbimit (kontratë shërbimi ose bashkepunimi) me manovratorë si eskavatorist, buldozeriste, automakiniste etj. Gjithashtu referuar edhe kërkesave të tjera për të patur në listëpagesa inxhinierë mjek specialiste të tjere na duket një numër shumë i ekzagjeruar personash në listëpagesa.

ix. Në DST kerkohen një numër shume i madh makinerish dhe pajisjesh të cilat janë shumë të tepruara për një volum të tillë punimesh

Mbështetur në analizen e punimeve të parashikuara nga ju në preventiv dhe mbështetur në Manualin e miratuar vkm nr.629 date 15/07 2015, perkatësishte në kapitullin e makineri - pajisjeve inxhinieret tanë arriten në konkluzionin që makineritë e kërkuara nga ana juaj janë të pajustifikuara dhe kërkojme të hiqen makinerit dhe pajisjet e tepërta nga kërkesat për kualifikim dhe vendosjen e tyre në përputhje me normat e shfrytëzimit të makinerive në analizat teknike të zerave të punës që jepen në VKM nr 629 date

15/07/2015 " Per miratimin e manualeve teknike të cmimeve të punimeve të ndertimit dhe të analizave teknike te tyre" Më poshtë sqarimi për mjetet e tepërta: Përsa i perket kamionave na duket tepër e ekzagjuar kërkesa për 7 kamiona mbi 15 ton, duke ditur gjerësinë e ngushte të rrugës dhe volume normale gjermuese dhe mbushëse 7 kamiona në këtë rrugë do të krijojnë një kaos të madh në trafik duke ditur që ajo është edhe një rrugë në shfrytëzim , gjatë kohës që do të punohet në të nuk mund të bllokohet trafiku sepse kalojnë mjete bujqësore me gjerësi të konsiderueshme si zëtorat, trailera apo autokombanjet. Për këtë shkak kush do OE që të kryejë këto punime është i detyruar të largojë këta kamiona të tepërt nga rruga ashtu siç ka ndodhur edhe nëmënjëri raste të tjera. Kërkojmë që të hiqet numri 7 dhe të kërkojnë vetëm 3 (tre) të tilla. Përsa i përket kamioncinave kërkesa për 4 cope të tilla na duket e ekzagjuar, kamioncinat përdoren për punime në qytet në rrugë me gjerësi më të vogël se 3 metra nuk e kuptojmë përse duhet një numër i konsiderueshëm kamioncinash në rrugën që ju po prokuroni, në këtë rast për ndonjë furnizim me karburant do të mjaftonte një e tilla. Kërkesa për 1 eskavator me krahe gjatë 18m është e tepërt për këtë objekt, duke ditur që kemi të bëjmë me punime në rrugë dhe në asnjë lloj thellimi të një baseni ujor apo të pastrimit të ndonjë kanali, këta janë eskavatore që përdoren vetëm për punime thellimi në lumenj det dhe basene të ndryshme ujore të cilat përdoren nga Bordi i kullimit, kjo kërkesë për këtë tip eskavatori është e pavend. -Kërkesa për dy eskavatore me goma dhe dy me zinxhira na duket e tepërt, për volumet e punës dhe duke ditur trafikun e kësaj rrugë do të mjaftonin dy deri në tre të tilla në total. - Bobcatit sipas volumeve të kërkuara dhe mjeteve të tjera në funksion të punimeve që ato kryejnë na duket i pakuptimtë dhe pa asnjë lloj funksioni në këtë rrugë, ai është mjet që përdoret në rrugë me gjerësi më të vogël se 3m. - Kërkesa për : Rul ngjeshës kapaciteti minimal 17 ton copë 2, Rul për shtresat kapaciteti 4 ton copë 2, Rul ngjeshës kapaciteti minimal 12 ton copë 2, është tepër i ekzagjuar, duke parë ngarkesat e një ruli 17 ton dhe të një ruli 12 ton nuk ka asnjë kuptim dhe diferencim për funksionin e njerit apo të tjetrit si ruli 12 ton si ruli 17 ton përdoren po për të njëjtin standart .rrugë të ndërtuara deri më sot në Republikën e Shqipërisë, pra kështu për 4 të tilla në total është tepër e ekzagjuar, volumeve të rrugës do të përshkruajë vetëm 1 rul 17 ose 12 ton sepse të njëjtin standart rrugë krijojnë.

Përsa i përket kërkesave për dy rula shtresash nuk mund të punojnë në të njëjtën kohë dy të tilla gjatë kohës që hidhet asfalt duke qenë se gjerësia e rrugës është e ngushtë 5m , mjafton vetëm një e tilla. -Përsa i përket autopompës ky është mjet që përdoret për të hedhur beton në lartësi të konsiderueshme pra në objekte që zhvillohen në lartësi 2 m e lart dhe jo për të hedhur beton në rrugë kërkesa për autopompe betoni është e tepërt sepse në rrugë betoni hidhet direkt nga autobetonierja me ndihmë edhe të pajisjeve që ajo ka për derdhjen e betonit.-Përsa i përket autobotit të ujit kërkojmë që të hiqet kriteri për dy cope të tilla pasi një autobot është i mjaftueshëm duke ditur gjatësinë e shkurtër të rrugës dhe gjerësinë e saj prej 5m .-Përsa i përket autobotit të naftës duke ditur që pranë kantierit të ndertimit ka 3 karburantë që punojnë nonstop na duket një kriter i pakuptimtë për të shtuar numrin e mjeteve të tepërta në rrugë të cilat pengojnë fluksin e automjeteve që përshkojnë gjatë

ditës këtë rrugë furnizimi i automjeteve të punës mund të kryhet direkt në karburantet në vijushmerine e këtij aksi rrugë ose me bidona me kamioncina të vogla të cilat nuk pengojnë qarkullimin dhe minimizojnë kostot e tepërta të rrugës të cilat ndikojnë edhe në konkurim nga OE ndryshëm ekonomike si shkak do të paraqiten me oferta më të mira. Kërkojme që të hiqet autoboti i naftës. -Persa i perket kompatorit ngjeshës nuke kuptojme perse mund të hyjë në punë një tillë kur ju keni kërkuar një thotë të tere me rula sa për të bërë një rrugë 20km të gjatë dhe jo sa kjo me gjatësi të papërfillshme në krahasim me mjetet që kërkon. -Përderisa keni kërkuar disa rula nuk keni pse kërkon kompator ngjeshës, kërkojme që të hiqen kompatores. - Kërkojme të hiqet kërkesa për Tabela Rrugore+ Semafore për bllokimin në rrugë 4cope sepse nuk mund të vendosesh me shume se dy të tillë një në fillim të rrugës dhe një në fund të rrugës. .[....]

II.2. Në datën 17.03.2017 autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.875/1 prot datë 17.03.2017 i kthen përgjigje palës ankimuese duke mos pranuar ankesën e operatorit ekonomik “Mane/S” shpk.

II.2.1. Në kthim përgjigje autoriteti kontraktor argumenton në mënyrë të përmbledhur si më poshtë vijon: “[...] Enti prokurues, Bashkia Sarandë ka zbatuar rregullat e prokurimit publik bazuar në ligjin nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar” dhe VKM 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Çdo kriter është vendosur në bazë të natyrës së punimeve dhe periudhës së realizimit të punimeve.”

II.3. Në datën 27.03.2017 pala ankimuese ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur në autoritetin kontraktor.

II.4. Në datën 12.04.2017 autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumenta cionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur pretendimin e palës ankimuese mbi modifikimin e dokumentave të tenderit në drejtim të kategorive të licencës së kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 10 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi është parashikuar se “

2. *Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e puneve të Kontrates.*

a. *License profesionale e Shoqërisë së vlefshme me kategorite:*

- *NP-1C (Punime germimi toke)*
- *NP-4C (Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai metro, pista aeroportuale)*
- *NP-5B (Punime nentokesore, ura dhe vepra arti)*
- *NP-12C(Punime të inxhinierisë së Mjedisit)*
- *NS-6A (Shtresa dhe mbistruktura speciale)*
- *NS- 18C (Punime Topogjeodezike) sipas modelit të leshuar MPPT*

Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

III.1.2. Në nenin 46, pika 1 gërma “a” dhe “b” ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : “ [...]1. *Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: a) kualifikimi profesional: çdo operatori ekonomik i kërkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për veprimtaritë e kërkuara dhe për të cilat do të lidhet kontrata; b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; [...]”*

III.1.3. Në nenin 26 pika 8 gërma “a” dhe “b” të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, parashikohet se “*Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:*

a) *licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose*

b) *dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose”*

III.1.4. Referuar parashtimeve me shkrim të operatorit ekonomik ankimes, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se në lidhje me pretendimin e mësipërm, ankimesi ka ngritur pretendime në lidhje me kërkimin e autoritetit kontraktor mbi disponueshmërinë e kategorisë së licencës në zbatim NP 12 dhe NS-18, si kërkim jo në proporcion në lidhje me natyrën dhe objektin e kontratës si edhe njëherazi ka ngritur pretendime në lidhje me nivelin e klasifikimit. Në lidhje me kundërshtimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimes, mbi modifikimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, për procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është me vend të ndalet në një test balancues të dy elementëve kryesorë. Së pari, nëse kërkesa në fjalë është e përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti, nëse kërkesa në fjalë shkon përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. Gjithashtu, në shqyrtimin e kriterit të mësipërm të kualifikimit, K.P.P. gjykon të ndalet edhe në faktin nëse kriteri i mësipërm është në proporcion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 46 pika 1 të LPP-së.

III.1.5. Në lidhjen nr.3 të Vendimit nr. 42, datë 16.01.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar, jepen shpjegimet për kategoritë e ndërtimeve (punimeve) të përgjithshme, ku përcaktohet: se për “Ndërtimet të Përgjithshme” (NP) “N.P. 12 Punime të inxhinierisë mjedisore Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose rristurime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimit të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar procesin e riaftësimit natyror, botanik, faunistik, konservimin dhe riaftësimin e terrenit të përdorur për karriera e gurore, dhe të bazeneve hidrografike, eliminimin e prishjes së ekuilibrit hidrogjeologjik nëpërmjet kthimit në toka buke të veprave për stabilizimin e shpatëve dhe rripullëzimeve të punimeve të sistemit bujqësor dhe të veprave për rivegjetizimin e skarpave rrugore, hekurudhor të karriera dhe mbetjeve inerte.” Ndërkohë, në lidhje me kategorinë e “Ndërtime të Punimeve Speciale” (NS), parashikohet se “N.S - 18 Punime topogjeodezike Konsiderohet zbatimi i rëlvimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh”.

III.1.6. Në VKM nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar, parashikohet:

“Lidhja 4

Niveli i shoqërisë sipas vlerave në lekë të punimeve të kryera për çdo kategori punimi

A (edhe për herë të parë) 0- 20 milion lekë

B 21- 50 milion lekë

C 51 - 100 milion lekë

D 101 - 200 milion lekë
E 201 - 400 milion lekë
F 401 - 800 milion lekë
G mbi 800 milion lekë”.

III.1.7. Në preventivin e punimeve të objektit, pjesë e dokumenteve të procedurës së prokurimit, objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar ndër të tjera, kryerjen e punimeve si me zëra punimesh si më poshtë vijon:

1: PUNIME NE TRUP TE RRUGES

1 Germim me makineri + transport materiali m³ 10,130.0
2 Germim me krahe seksion detyruar me gjerësi $b > 1m$, $h = 1.5m$, tok e zak m³ 300.0
3 Skarifikim skarpate m² 300.0
4 Shtrese cakell guroreje $t = 30cm$ + cilindrim m² 25,415.0
5 Shtrese stabilizanti 20cm m² 25,415.0 6 Shtrese binderi 6cm m² 20,800.0 TOTALI NO.1

KATEGORIA Nr 2: PUNIME NE VEPRA ARTI TE VOGLA

1 Tombino me tuba betoni Ø 800, mbi shtrese betoni ml 104.0
2 Kemishe beton M300 m³ 64.0
3 Germim dheu me seksion te detyruar + transport m³ 348.0

KATEGORIA Nr 3: PUNIME TE NDRYSHME

1 Mbjellje bari m² 396.03
2 F.V.Fidane Peme dekorative cope 20

III.1.8. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

III.1.9. Në rastin konkret K.P.P. konstaton se synimi bazë i autoritetit kontraktor (është vërtetimi se subjektet ofertues disponojnë kategoritë përkatëse të licencës NP 12 dhe NS 18 për kryerjen e punimeve, sipas klasifikimeve të kërkuara. Konkretisht, KPP konstaton se ndër të tjera, referuar preventivit të punimeve autoriteti kontraktor ka parashikuar punime të ndryshme si *Germim me makineri + transport materiali*, *Germim me krahe seksion detyruar me gjerësi*, *Skarifikim skarpate*, *Shtrese cakell guroreje*, *Shtrese stabilizanti* si edhe punime në vepra arti të vogla (tombino, këmishë betoni, gërmime dheu) dhe punime të ndryshme (mbjellje bari dhe pemë dekorative). Sa më sipër, KPP gjykon se referuar, natyrës së punimeve të mësipërme, për këto të fundit, shfaqet e nevojshme disponueshmëria e kategorive të licencës për zbatim NP 12 dhe NS 18, si punime të cilat përfshihen në grupin e punimeve parashikuar në lidhjen nr.3 të Vendimit

nr. 42, datë 16.01.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se niveli i klasifikimit nuk është në përputhje me volumin e kontratës, objekt prokurimi, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se referuar fondit limit të përlogaritur nga autoriteti kontraktor për procedurën e mësipërme të prokurimit, i cili është 76,573,764 lekë (pa TVSH), evidentohet qartë se niveli i klasifikimit “C”, për vlerë punimesh 51-100 milion lekë, është brenda vlerës së lejuar për përmbushjen e objektit të kontratës objekt prokurimi. Sa më sipër, KPP gjykon se në përgjigje të testit të proporcionalitetit të mësipërme, kërkitimi i autoritetit kontraktor mbi disponueshmërinë e kategorive të licencës sipas klasave si më sipër kërkuar, parë kjo në raport (proporcion) me vlerën dhe natyrën e punimeve, detyrimet që rrjedhin nga akti nënligjor është një kërkesë në përpjestim me natyrën dhe objektin e punimeve dhe nuk shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi me argumentin se “Te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, “Kapaciteti teknik”, pika 2.1, është kërkuar ne kundërshtim te hapur me parashikimin ligjor: 2.1 Mbështetur në natyrën e punimeve te parashikuara ne projekt-preventiv, duhet qe operatori ekonomik te disponoje licencat e nevojshme (lëshuar nga QKL). Për këtë duhet te paraqesin licencat: -Licence lidhur me ndikimin ne mjedis te lëshuar nga QKL. Kodi III.2.A. Të nderuar ju bëjmë me dije se ne bazë të ligjit Nr. 10440, data 7.7.2011 PER VLERESIMINE NDIKIMIT NE MJEDIS, Kreu 2, neni 7, VNM duhet të hartohet nga ekspert të licencuar dhe të pavarur, të pajisur me licence QKL Kodi 111.2.A, përpara dhënies se lejes nga autoriteti përgjegjës për zhvillimin ose jo te projektit.....Në këto kushte kërkojmë heqjen e këtij kriteri te vendosur ne kundërshtim te hapur me kërkesat Ligjorë qe parashtuam me lart, por edhe ne kundërshtim te hapur me kërkesat e nenit 26 te VKM nr. 914 date 29.12.2014 “Rregullat e prokurimit Publike” i ndryshuar dhe nenin 46 te Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Ligjit te Prokurimin Publik” i ndryshuar, ku parashikohen në mënyre shteruese kriteret që mund te kërkoje autoriteti kontraktor. “ Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 10 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi është parashikuar se “

Mbështetur në natyrën e punimeve të parashikuara në projekt-preventiv, duhet që operatori ekonomik të disponoje licensat e nevojshme (lëshuar nga QKL). Për këtë duhet të paraqesin licencat:

-Licence lidhur me ndikimin ne mjedis te leshuar nga QKL. Kodi III.2.A .”

III.2.2. Në nenin 26, pika 8, gërma “a” e Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose[...]

III.2.3. Në seksionin “Kategoria III.2. “ Shërbime Ekspertizë ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis” , nëseksioni “Licencimi i kategorisë III.2.A”, pika 4 dhe 5 të Vendimit nr.538 datë 26.05.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashëkta”, të ndryshuar parashikohet se:“ II. LICENCIMI I VEPRIMTARIVE TË NËNKATEGORISË III.2.A 4. Veprimtaritë e nënkategorisë III.2.A specifikohen në vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe në auditimin mjedisor me kodet respektive A.1 dhe A.2. 5. Një subjekt mund të pajiset me një licencë të kategorisë III.2.A, për një apo të dyja veprimtaritë specifike në përputhje me masën e plotësimit të kriterëve të detajuara respektive, në të njëjtën kohë ose në kohë të ndryshme.”

III.2.4. Në nenin 8 e ligjit nr.10440 datë 7.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, i ndryshuar, parashikohet se “Neni 8

Projektet që i nënshtrohen vlerësimit paraprak të VNM-së

Projektet që i nënshtrohen vlerësimit paraprak të ndikimit në mjedis janë:

- a) projektet e listuara në shtojcën II, bashkëlidhur;
- b) çdo ndryshim a shtesë në projektet e listuara në shtojcën I apo II, të licencuara paraprakisht, që mund të shkaktojë efekte të rëndësishme negative mbi mjedisin;
- c) projektet e listuara në shtojcën I, që ndërmerren, ekskluzivisht apo kryesisht, për testimin dhe zhvillimin e metodave ose produkteve të reja, të cilat nuk janë përdorur për më shumë se dy vjet;
- ç) projektet e listuara apo jo në shtojcën I ose II, që nuk kanë ndikim të drejtpërdrejtë apo nuk janë të nevojshme për administrimin e zonave veçanërisht të mbrojtura, por që, veçmas apo në bashkëveprim me plane dhe projekte të tjera, mund të shkaktojnë efekte negative të rëndësishme në këto zona. Në këtë rast, raporti paraprak i VNM-së përfshin edhe vlerësimin e ndikimeve të këtyre projekteve në atë zonë, duke marrë parasysh objektivat e ruajtjes dhe mbrojtjes së vendit ku do të zbatohet projekt”

III.2.5. Në nenin 20 pika 4 e ligjit nr.10440 datë 7.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, i ndryshuar, parashikohet se: “Zhvilluesi, gjatë fazës së zbatimit të projektit, i raporton ministrisë për masat e marra për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet negative të veprimtarisë.”

III.2.6. Gjithashtu në kreun IV pikën 1 të Vendimit nr. 686 datë datë 29.7.2015 “Për Miratimin E Rregullave, Të Përgjegjësi E Të Afateve Për Zhvillimin E Procedurës Së Vlerësimit Të

Ndikimit Në Mjedis (VNM) Dhe Procedurës Së Transferimit Të Vendimit E Deklaratës Mjedisore” parashikohet se : *“Gjatë zbatimit të projektit, zhvilluesi ka përgjegjësinë të kryejë monitorimin e ndikimeve të tij në mjedis, në përputhje me përcaktimet në deklaratën mjedisore dhe legjislacionin në fuqi”*

III.2.7. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

III.2.5. Në lidhje me kundërshtimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues, mbi modifikimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit për procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është me vend të ndalet në një test balancues të dy elementëve kryesorë. Së pari nëse kërkesa në fjalë është e përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti nëse kërkesa në fjalë shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. Gjithashtu, në shqyrtimin e kriterit të mësipërm të kualifikimit, K.P.P. gjykon të ndalet edhe në faktin në rast se kriteri i mësipërm është në proporcion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 46 pika 1 të LPP-së.

III.2.8. Në përgjigje të testit të mësipërm të proporcionalitetit, KPP vlerëson të sqarojë se referuar kriterëve të veçanta të kualifikimit, preventivit të punimeve dhe natyrës së punimeve, autoriteti kontraktor në asnjë rast nuk ka parashikuar nga ana e operatorit ekonomik fitues i kontratës së procedurës së prokurimit objekt ankimi hartimin e raportit paraprak apo raportit të thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis referuar parashkrimeve të ankimuesit. Por nga ana tjetër, në respekt të nenit 20 pika 4 të *lex specialis* ligjit nr.10440 datë 7.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, i ndryshuar, *Zhvilluesi, gjatë fazës së zbatimit të projektit, i raporton ministrisë për masat e marra për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet negative të veprimtarisë.*” Në nenin 20 pika 4 e ligjit nr.10440 datë 7.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, i ndryshuar, parashikohet se: *“Projekt” është: a) zbatimi i punimeve të ndërtimit apo instalimeve ose skemave të tjera; b) ndërhyrje të tjera në mjedisin dhe peizazhin natyror, përfshirë edhe ndërhyrjet që kanë të bëjnë me nxjerrjen e mineraleve,* duke përfshirë njëherazi edhe projektin e procedurës së prokurimit objekt ankimi. KPP gjykon se operatori ekonomik fitues i kontratës së prokurimit objekt ankimi në cilësinë e zbatuesit të punimeve dhe në respekt të parashkrimeve që rrjedhin nga neni 20 pika 4 e *lex specialis* dhe aktit nënligjor në zbatim të ligjit duhet të raportojë pranë autoritetit kontraktor në cilësinë e zhvilluesit të punimeve në kuptim të ligjit nr.10440 datë 7.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, i ndryshuar, *për masat e marra për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet negative të veprimtarisë.* Sa më sipër, KPP vlerëson se kërkesa e autoritetit kontraktor se subjekti njëherazi duhet të jetë i licencuar për vlerësimin e ndikimit në

mjedis në përputhje me detyrimet ligjore që rrjedhin nga ky i fundit për raportimin pranë autoritetit kontraktues është një kriter në përputhje me natyrën dhe volumin e procedurës së prokurimit objekt ankimi, nuk tejkalon qëllimin e autoritetit kontraktor dhe nuk shfaq diskriminim mes ofertuesve.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e palës ankimuese mbi modifikimin e dokumentave të tenderit me argumentin se “[...]Te Kriteret e Veçanta për Kualifikim, "Kapaciteti teknik", pika 11, është kërkuar në kundërshtim të hapur me parashikimin Ligjor: Certifikate Sistemin e administrimit të sigurisë së informacionit (ISO 27001 -2005 e vlefshme)/ Kjo kërkesë është në kundërshtim të hapur me kërkesat e parashikuara në nenin 46 të LPP dhe nenin 26, të VKM 914 date 29.12.2014. Sipas kërkesave ligjore të parashikuara në Ligjin e Prokurimit Publik Nr. 9643 date 20.11.2006 i ndryshuar, kërkesa juaja presa i përket certifikatës të kërkuar, konkretisht ISO 2700 I :2005, është e pambështetur pasi karakteristika e kësaj ISO, nuk kanë të bëjnë aspak me objektin e prokurimit [...]”Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Lidhur mbi pretendimet për modifikimin e kriterëve të veçanta të kualifikimi, KPP konstaton se në shtojcën 10 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, “Kapaciteti Teknik”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi është parashikuar se “

1. Shoqëria duhet të paraqesë Certifikatë e cilesisë së punimeve për ndertime civile , punime në rrugë etj :
2. Certifikatë : Sistemi i menaxhimit të cilesisë (ISO 9001- 2008 e vlefshme)
3. Certifikatë : Sistemi i menaxhimit të mjedisit (ISO 14 001-2004 e vlefshme)
4. Certifikatë : Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në punë (OHSAS – 18001-2007 e vlefshme)
5. Certifikatë :Sistemi i integruar i menaxhimit (PAS 99: 2012 e vlefshme)
6. Certifikatë : Sigurimi në trafikun rrugor(ISO 39001 -2012 e vlefshme).
7. Certifikatë : Sistemin e administrimit të sigurisë së informacionit (ISO 27001 -2005 e vlefshme)

III.3.2. Në preventivin e punimeve të objektit, pjesë e dokumenteve të procedurës së prokurimit, objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar ndër të tjera, kryerjen e punimeve si me zëra punimesh si më poshtë vijon:

1: PUNIME NE TRUP TE RRUGES

1 Germim me makineri + transport materiali m³ 10,130.0

2 Germim me krahe seksion detyruar me gjerësi b>1m, h=1.5m, tokë e zak m³ 300.0

3 Skarifikim skarpate m² 300.0

4 Shtrese cakell guroreje $t=30\text{cm}$ + cilindrim m^2 25,415.0

5 Shtrese stabilizanti 20cm m^2 25,415.0 6 Shtrese binderi 6cm m^2 20,800.0 TOTALI NO.1

KATEGORIA Nr 2: PUNIME NE VEPRARTE TE VOGLA

1 Tombino me tuba betoni Ø 800, mbi shtrese betoni ml 104.0

2 Kemishe beton M300 m^3 64.0

3 Germim dheu me seksion te detyruar+transport m^3 348.0

KATEGORIA Nr 3: PUNIME TE NDRYSHME

1 Mbjellje bari m^2 396.03

2 F.V.Fidane Peme dekorative cope 20

III.3.3. Në nenin 46 pika 1 gërma “a” dhe gërma “b” e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese:

a) kualifikimi profesional: çdo operatori ekonomik i kërkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për veprimtaritë e kërkuara dhe për të cilat do të lidhet kontrata;

b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;

III.3.4. Në nenin 46, pika 2 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “[...] Autoriteti kontraktor mund të kërkojë edhe certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit. [...]”.

III.3.5. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 30 “Kërkesat e cilësisë”, përcaktohet se:

“1. Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga sistemet e standardizimit kombëtar ose ndërkombëtar.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

2. Certifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit”.

III.3.6. Komisioni i Prokurimit Publik, nisur nga sa më lart, vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Çertifikata ISO 27001:2005 (e kërkuar nga autoriteti në DT) është një standard që rregullon sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit, pra ka të bëjë me teknologjinë e informacionit. ISO 27001:2005 specifikon kërkesat për krijimin, zbatimin, mirëmbajtjen dhe vazhdimisht përmirësimin e sistemit të menaxhimit të sigurisë së informacionit në kontekstin e organizatës. Ajo gjithashtu përfshin kërkesat për vlerësimin dhe trajtimin e rreziqeve të sigurisë të informacionit të përshtatura për nevojat e organizatës, me qëllim që informacioni të mbetet i sigurtë. Komisioni i Prokurimit Publik, bazuar edhe në dokumentacionin e kësaj procedure prokurimi, preventivit të publikuar prej tij, gjykon se kërkesa për këtë kriter është e ekzagjeruar dhe jo në përpjesëtim të drejtë me volumin e kontratës, objektin e prokurimit dhe zërat e punimeve të parashikuara në preventiv, duke vlerësuar se nuk është e nevojshme kërkesa për paraqitjen e një dokumenti të tillë e si rrjedhim pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues mbi modifikimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit në drejtim të fuqisë mesatare të punonjësve të kërkuar si edhe stafit teknik të disponueshëm të kërkuar për realizimin e kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në shtojcën 10 “*Kriteret e Veçanta të Kualifikimit*”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi është parashikuar se “

4. *Një punësim mesatar i të paktën 120 (njqind e pesedhjetë) personave, për periudhën Shkurt 2015 –Shkurt 2017 të vërtetuar me;*

i. *Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; per periudhen Shkurt 2015 –Shkurt 2017*

ii. *List pagesat e punonjesve per perudhen Shkurt 2015 –Shkurt 2017 te konfirmuar nga Administrata Tatimore shoqeruar keto dhe me formularet e deklarimit te pagesave per sigurimet shoqerore e shendetesore TAP, urdher xhirime në të cilët duhet të jenë të përfshirë dhe Stafit teknik të mëposhtëm:*

- *2(dy) inxhinier Ndertimi*
- *2(dy) inxhiner Gjeodet*

- 1 (një) inxhinier Hidroteknik
- 1 (një) inxhinier Elektrik
- 1 (një) inxhinier Mekanik
- 1 (një) inxhinier Mjedisi
- 1 (një) inxhinier Gjeolog
- 1 (një) inxhinier Agronom

Operatori ekonomik duhet te kete ne licencen e shoqerise drejtuesit tekik:

- 1(dy) inxhinier Ndertimi
- 1(dy) inxhinier Gjeodet
- 1 (një) inxhinier Hidroteknik
- 1 (një) inxhinier Elektrik
- 1 (një) inxhinier Mekanik
- 1 (një) inxhinier Mjedisi
- 1 (një) inxhinier Gjeolog
- 1 (një) inxhinier Agronom

për të vertetuar plotësimin e këtij kriteri, Operatorët Ekonomike duhet të paraqesin diplomat, kontratat e punës dhe CV përkatëse, librezat e punës.

Drejtuesit teknik duhet te jene te perfshire ne listpagesa per periudhen Shkurt 2015- Shkurt 2017.

Drejtuesit Teknik duhet te jene me nje pervoje pune minimumi 5 vjecare.

iii. Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te pakten nje inxhinier te shoqerise qe te disponoje deshmi trajnimi si "Specialist per sigurimin teknik dhe shendetin ne pune "ne perputhje me klauzolat e ligjit Nr 10327 date 18/02/2010 "Per sigurine dhe shendetin ne pune " dhe V.K.M nr.312, date 05.05.2010 "Per miratimin e rregullores "Per sigurine ne kantier "

Per drejtuesin teknik te shoqerise duhet te paraqitet certifikata e trajnimit për "Pergjegjes per sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit ne Pune" e dhëne nga nje organizem i licensuar certifikimi shqiptar ose i huaj si dhe kontrata e punes.

iv. Te kete ne staf te punesuar dhe te figurojne ne listpagesa per periudhen e kerkuar me eksperience mbi 15- vjet nje inxhinier mjedisi, të paraqitet diploma, kontrata e punës, CV,

librezat e punes, certifikata e specialistit leshuar nga Ministria e Mjedisit. (Kjo pike shkon paralelisht me piken 2.1 te kriterreve, pasi qe nje operator te mare licence nga QKL III.2.A duhet te kete ne menyre te domosdoshme inxhinier mjedisi me nje eksperience 15 vjecare dhe te kete certifikata e specialistit leshuar nga Ministria e Mjedisit)

v. Te kete ne stafin e tij per realizimin e kontrates, dy teknik topograf, nje teknik mekanik, nje teknik hidraulik te shoqeruar me deftesat(diplomat) profesionale dhe kontratat e punes dhe te jene te regjistruar ne kompanine e tij te figurojne ne listpagesa.

vi. Per gjithë drejtuesit e makinerive te renda , sipas Urdher Nr.44, datë 4.2.2004 “Per miratimin e rregullores “Per Procedurat dhe kriteret per dhenien e lejeve te manovrimit perdoruesve te makinerive te renda te ndertimit dhe disiplinimi i perdorimit te makinerive te ndertimit” Dëshmi te aftësisë profesionale ose leje manovrimi te vlefshme leshuar nga Ministria e Transportit dhe Infrastruktures te vlefshme, minimumi 5 automakinista, 1 eskavatorist me zinxhir, 2 eskavatorist me goma, 2 buldozerist te shoqeruar me kontratat e punes dhe të figurojne ne listpagesa.

Të ketë në stafin e punonjësve të pasqyruar në listepagesa të paktën 30 (tridhjetë) punonjes te pajisur me kartelat personale te sigurimit teknik, te leshuara nga organe kompetente të akredituara ne baze te ligjit nr. 8734, date 01.02.2001 dhe ligjit Nr.13/2013, date 14.02.2013 , ku te perfsihen elektriciste, hidraulike , mekanik, saldator). (zhvillimi i punes ka te domosdoshme pranine e punonjesve te kualifikuar ne 120 punonjes duhet te jene te pakten 30 specialist) “

III.4.2. Në nenin 46, pika 1 gërma “a” dhe “b” ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : “ [...]1. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: a) kualifikimi profesional: çdo operatori ekonomik i kërkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për veprimtaritë e kërkuara dhe për të cilat do të lidhet kontrata; b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; [...]”

III.4.3. Në nenin 26 pika 8 gërma “a” dhe “b” të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, parashikohet se “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomikisht nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose”

III.4.4. Në lidhje me kundërshtimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues, mbi modifikimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, për procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është me vend të ndalet në një test balancues të dy elementëve kryesorë. Së pari, nëse kërkesa në fjalë është e përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti, nëse kërkesa në fjalë shkon përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. Gjithashtu, në shqyrtimin e kriterit të mësipërm të kualifikimit, K.P.P. gjykon të ndalet edhe në faktin nëse kriteri i mësipërm është në proporcion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 46 pika 1 të LPP-së.

III.4.5. Referuar parashtrimeve me shkrim të operatorit ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se në lidhje me pretendimin e mësipërm, ankimuesi ka ngritur njëherazi disa pretendime në drejtim të kriterit të mësipërm të kualifikimit. Konkretisht,, KPP konstaton se ankimuesi ka parashtruar fillimisht pretendime në lidhje me numrin mesatar të punëtorëve të kërkuar si dëshmi e fuqisë punëtore, prej 120 punonjësish. Gjithashtu, operatori ekonomik ankimues, referuar ankesës së dorëzuar pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik ka parashtruar pretendime në lidhje me kërkesën për të paraqitur përveç Vërtetimit të lëshuar nga Administrata Tatimore edhe listat e konfirmuara nga tatimet, edhe formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore e shëndetësore TAP dhe urdhër xhirime në të cilët duhet të jenë të përfshirë dhe Stafit teknik. Gjithashtu, ankimuesi ka parashtruar pretendime në lidhje me kërkimin e autoritetit kontraktor mbi listat e dy viteve të fundit (si periudhë kohore). Lidhur me stafin teknik të kërkuar, operatori ekonomik ankimues, ka parashtruar pretendimet se kërkesa në lidhje me disponueshmërinë e stafit teknik (2 inxhinier gjeodet, mekanik, gjeolog dhe agronom) nuk është në përpjestim me natyrën dhe objektin e procedurës së prokurimit. Ankimesi ka parashtruar gjithashtu pretendime në lidhje me disponueshmërinë e një inxhinieri mjedisi me mbi 15 vite eksperiencë. Në lidhje me stafin teknik (jo inxhinier), KPP konstaton se operatori ekonomik ankimues ka parashtruar pretendime në lidhje me teknik e kërkuar (topograf, mekanik, hidraulik, 30 punonjësit e kërkuar të certifikuar nga ISHTI (ose organe të akredituara certifikimi) si edhe në lidhje me disponueshmërinë e manovratorëve të mjeteve të rënda. Sa më sipër, KPP gjykon se përsa kohë kemi të bëjmë me një kriter të veçantë kualifikimi, gjykon të trajtojë sëbashku. Në lidhje me kundërshtimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues, mbi modifikimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, për procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është me vend të ndalet në një test balancues të dy elementëve kryesorë. Së pari, nëse kërkesa në fjalë është e përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti, nëse kërkesa në fjalë shkon përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. Gjithashtu, në shqyrtimin e kriterit të mësipërm të kualifikimit, K.P.P. gjykon të

ndalet edhe në faktin nëse kriteri i mësipërm është në proporcion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 46 pika 1 të LPP-së.

III.4.6. Në lidhje me kundërshtimin e parë të operatorit ekonomik ankimues, mbi numrin mesatar të dëshmisë së fuqisë punëtore të kërkuar, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se, referuar kritereve të veçanta të kualifikimit, autoriteti kontraktor ka kërkuar ndër të tjera se operatorët ekonomikë pjesëarrës duhet të dëshmojnë një punësim mesatar i të paktën 120 (njqind e pesedhjetë) personave, për periudhën Shkurt 2015 –Shkurt 2017. Referuar preventivit të punimeve të procedurës së prokurimit, objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar ndër të tjera, kryerjen e punimeve si me zëra punimesh si më poshtë vijon:

1: PUNIME NE TRUP TE RRUGES

1 Germim me makineri + transport materiali m³ 10,130.0

2 Germim me krahe seksion detyruar me gjerësi b>1m, h=1.5m, tok e zak m³ 300.0

3 Skarifikim skarpate m² 300.0

4 Shtrese cakell guroreje t=30cm + cilindrim m² 25,415.0

5 Shtrese stabilizanti 20cm m² 25,415.0 6 Shtrese binderi 6cm m² 20,800.0 TOTALI NO.1

KATEGORIA Nr 2: PUNIME NE VEPRA ARTI TE VOGLA

1 Tombino me tuba betoni Ø 800, mbi shtrese betoni ml 104.0

2 Kemishe beton M300 m³ 64.0

3 Germim dheu me seksion te detyruar+transport m³ 348.0

KATEGORIA Nr 3: PUNIME TE NDRYSHME

1 Mbjellje bari m² 396.03

2 F.V.Fidane Peme dekorative cope 20

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton ndër të tjera se referuar dokumenteve të procedurës së prokurimit, seksioni Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin, autoriteti kontraktor ka parashikuar afatin 60 ditë për kryerjen e punimeve.

III.4.7. Gjithashtu, KPP konstaton se në Kreun III “Kategorizimi Dhe Klasifikimi I Licencës, Elementet E Saj, Kushtet, Kriteret Dhe Kufizimet” të Vendimin nr.42 të Këshillit të Ministrave datë 16.01.2008 “Për Miratimin e Rregullores për Kriteret dhe Procedurat e Dhënies së Licencave Profesionale të Zbatimit, Klasifikimit dhe Disiplinimit të Subjekteve Juridike, që Ushtrjnë Veprimtari Ndërtimi” parashikohet se c) Autoritetet kontraktore, në përcaktimin e grafikëve dhe afateve për përfundimin e punimeve të ndërtimit, në dokumentet e tenderit të prokurimit dhe në kontratën e zbatimit të veprave publike, ndërtimore, detyrohen të llogarisin kryerjen e punimeve, për periudhën 22 mars – 23 tetor me 2(dy) turne, për ndërtimin e objekteve në lartësi, dhe me 3(tri) turne, për ndërtimin e rrugëve dhe ndërtimeve të tjera. ç) Autoritetet kontraktore për moszbatimin e kërkesave të përcaktuara në shkronjën “c” dhe për mosndjekjen e

zbatimin e këtyre kushteve (kryerjen e punimeve me dy e tri turne), të përcaktuara në kontratën e nënshkruar, ngarkohen me përgjegjësi administrative dhe/ose me përgjegjësi, sipas legjislacionit për prokurimin publik.

III.4.8. Në rastin konkret K.P.P. konstaton se synimi bazë i autoritetit kontraktor (referuar njëherazi edhe proces-verbalit të miratimit të dokumenteve të tenderit) është vërtetimi se subjektet ofertues zotërojnë stafin e duhur për kryerjen e punimeve në përputhje me kohëzgjatjen e parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit dhe njëherazi në përputhje me turnet e parashikuar nga akti nënligjor në zbatim të ligjit. Sa më sipër, KPP gjykon se në përgjigje të testit të proporcionalitetit të mësipërme, kërkitimi i autoritetit kontraktor mbi disponueshmërinë e 120 punonjësve si dëshmi e fuqisë mesatare të punonjësve, parë kjo në raport (proporcion) me kohëzgjatjen e zbatimit të punimeve të parashikuar prej vetëm 60 ditë, për të cilëna ankimuesi në asnjë rast nuk ka ngritur pretendime, vlerën dhe natyrën e punimeve, detyrimin nga akti nënligjor për kryerjen e punimeve në tre turne si edhe kohëzgjatjen maksimale të kohës së punës referuar Kodit të Punës, është një kërkesë në përpjestim me natyrën dhe objektin e punimeve dhe nuk shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese nuk qëndron.

III.4.9. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik për heqjen e kriterit për formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore e shëndetsore dhe TAP, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se për të vërtetuar numrin e punonjësve autoriteti kontraktor ka kërkuar disa dokumenta si: *Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; per periudhen Shkurt 2015 –Shkurt 2017;ii. List pagesat e punonjesve per perudhen Shkurt 2015 –Shkurt 2017 te konfirmuar nga Administrata Tatimore shoqeruar keto dhe me formularet e deklarimit te pagesave per sigurimet shoqerore e shendetesore TAP, urdher xhirime në të cilët duhet të jenë të përfshirë dhe Stafit teknik të mëposhtëm:*

III.4.10. Sa më sipër rezulton se autoriteti kontraktor për të vërtetuar numrin e punonjësve ka kërkuar një sërë dokumentash qëllimi i të cilave është të vërtetojë që një operator ekonomik disponon një numër të caktuar punonjësish. Nga sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se për autoritetin kontraktor e rëndësishme është të vërtetohet zotërimi i numrit të kërkuar të punonjësve vërtetuar me dokumentacion të lëshuar nga organe shtetërore dhe që janë të verifikueshme nga autoriteti kontraktor gjatë periudhës së shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave dhe nuk është e nevojshme të kërkojnë paraqitja e një sërë dokumentash të cilat në thelb vërtetojnë të njëjtën gjë, duke mos krijuar barriera dhe pengesa operatorëve ekonomikë të interesuar për një procedurë prokurimi. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret për kualifikim duhet të vendosen nga autoriteti kontraktor në përputhje me objektin e prokurimit, natyrën e kontratës, volumin e saj dhe në përputhje e përpjesëtim me këto të dhëna. Në këtë rast

për vërtetimin e numrit të punonjësve kriteri për paraqitjen e formularëve të deklarimit si dhe dokumentave TAP dhe urdhër xhirimet janë të ekzagjeruar dhe jo në përpjesëtim me objektin e kontratës. Autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimet përkatëse duke hequr kriteret e ekzagjeruara dhe jo në përputhje me objektin dhe natyrën e prokurimit.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron vetëm për paraqitjen e formularëve të deklarimit si dhe dokumentave TAP dhe urdhër xhirimet autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimin duke i hequr këto kërkesa të ekzagjeruara.

III.4.11. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues, se kërkimi i autoritetit kontraktor mbi dorëzimin e listëpagesave të dy viteve të fundit është e ekzagjeruar dhe ky kriter duhet reduktuar në 12 muajt e fundit, KPP konstaton se referuar nenit 26 pika 8 gërma “a” dhe “b” të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, parashikohet se *“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;.* Për një interpretim të drejtë të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues nga njëra anë dhe synimit të autoritetit kontraktor nga ana tjetër mbi provimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale, KPP gjykon se përsa kohë në aktin nënligjor nuk është parashikuar koha maksimale apo minimale e kërimit të disponueshmërisë së fuqisë punëtore, KPP gjykon të drejtohet një prej metodave të interpretimit ligjor, interpretimi sistematik, i cili vërteton domethenjen e drejtë të normës juridike duke e vënë në lidhmëri me normat e tjera brenda sistemit juridik. Kjo do të thotë se norma juridike s’mund të interpretohet si e vetme, e ndarë prej tërësisë së vet, prej normave të tjera juridike. Sa më sipër, KPP gjykon se referuar frymës së ligjit dhe aktit nënligjor në zbatim të tij, në kërkimin e dokumenteve të tjera mbi plotësimin e kapacitetit teknik dhe atij financiar autoriteti kontraktor i referohet kërimit të dëshmive të tre viteve të fundit (bilance, kontrata të ngjashme etj). Sa më sipër, kërkimi i autoritetit kontraktor, i dëshmive të fuqisë punëtore të dy viteve të fundit është në respekt të frymës së parashikimeve të mësipërme dhe nuk është një kriter i vendosur jo në proporcion me natyrën dhe objektin e kontratës.

III.4.12. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues mbi disponueshmërinë e inxhinierëve, 2 inxhinier gjeodet, një inxhinier, mekanik dhe një inxhinier gjeolog, dhe inxhinier agronom duke parashtruar argumente se këto të fundit nuk janë në përpjesëtim me natyrën dhe volumin e kontratës objekt prokurimi, Komisioni i Prokurimit Publik. konstaton se, autoriteti kontraktor ka parashikuar në kriteret e veçanta të kualifikimit disponueshmërinë e stafit teknik të kualifikuar, 2 (dy) inxhinier Gjeodet, 1 (një) inxhinier Mekanik 1 (një) inxhinier Gjeolog 1 (një) inxhinier Agronom . persona të cilët duhet të figurojnë njëherazi edhe në licencën e shoqërisë në cilësinë e drejtuesit. Referuar, preventivit të punimeve të parashikuar autoriteti kontraktor ka parashikuar ndër të tjera, kryerjen e punimeve si me zëra punimesh si më poshtë vijon:

1: PUNIME NE TRUP TE RRUGES

1 Germim me makineri + transport materiali m³ 10,130.0
 2 Germim me krahe seksion detyruar me gjeresi b>1m, h=1.5m, tok e zak m³ 300.0
 3 Skarifikim skarpate m² 300.0
 4 Shtrese cakell guroreje t=30cm + cilindrim m² 25,415.0
 5 Shtrese stabilizanti 20cm m² 25,415.0 6 Shtrese binderi 6cm m² 20,800.0 TOTALI NO.1
KATEGORIA Nr 2: PUNIME NE VEPRARTI TE VOGLA
 1 Tombino me tuba betoni Ø 800, mbi shtrese betoni ml 104.0
 2 Kemishe beton M300 m³ 64.0
 3 Germim dheu me seksion te detyruar+transport m³ 348.0
KATEGORIA Nr 3: PUNIME TE NDRYSHME
 1 Mbjellje bari m² 396.03
 2 F.V.Fidane Peme dekorative cope 20

III.4.12.1. Në rastin konkret K.P.P. konstaton se synimi bazë i autoritetit kontraktor (referuar njëherazi edhe proces-verbalit të miratimit të dokumenteve të tenderit) është vërtetimi se subjektet ofertues zotërojnë staf të kualifikuar teknik (inxhinierët e sipërcituar të cilët janë njëherazi dhe drejtues teknik) për kryerjen e punimeve në përputhje me kohëzgjatjen e parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit dhe njëherazi në përputhje me turnet e parashikuar nga akti nënligjor në zbatim të ligjit. Në nenin 8 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Per Kontrollin Dhe Disiplinimin E Punimeve Te Ndertimit” parashikohet se “Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas apo të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore.” Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose europiane. Me materiale dhe produkte ndërtimi kuptohet çdo produkt i prodhuar për t'u përfshirë në mënyrë të përhershme në punimet e ndërtimit.” Sa më sipër, në interpretim të dispozitave të mësipërme, zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga personat të pajisur me licencë (drejtuesit teknik të shoqërisë), të cilët njëherazi mbajnë përgjegjësi për realizimin e punimeve në përputhje me kushtet e kërkuara nga ana e autoritetit kontraktor. Në lidhje me disponueshmërinë e inxhinierit gjeolog, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që autoriteti kontraktor, në preventivin e punimeve nuk ka parashikuar punime të një natyre në të cilën shfaqet e nevojshme disponueshmëria dhe drejtimi i punimeve nga një inxhinier gjeolog, parë kjo në raport edhe me pikat dhe kategoritë përkatëse të licencës së kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor, KPP konstaton se kriteri i mësipërm nuk është në përputhje dhe proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës dhe si një kriter i tillë duhet ndryshuar. Në lidhje me disponueshmërinë e dy inxhinierëve gjeodet, një prej të cilëve duhet të figurojë drejtues teknik në licencë, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se ndër të tjera autoriteti kontraktor ka parashikuar kryerjen e punimeve të një natyre topogjeodezike, kjo pasqyruar edhe në kërkimin e

kategorisë NS 18 të licencës. Në lidhje me kategorinë e “Ndërtime të Punimeve Speciale” (NS), parashikohet se “*N.S - 18 Punime topogjeodezike Konsiderohet zbatimi i rilevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh*”. Sa më sipër KPP gjykon se kërkitimi i autoritetit kontraktor mbi disponueshmërinë dhe drejtimin e punimeve nga inxhinier gjeodet, është në përputhje me natyrën dhe volumin e kontraktës.

III.4.12.2. Ndërkohë në lidhje me numrin dy të inxhinierëve të kërkuar, ku njëri prej të cilëve duhet të figurojë si drejtues teknik në licencën e shoqërisë, KPP vëren se në Kreun III “*Kategorizimi Dhe Klasifikimi I Licencës, Elementet E Saj, Kushtet, Kriteret Dhe Kufizimet*” të Vendimin nr.42 të Këshillit të Ministrave datë 16.01.2008 “*Për Miratimin e Rregullores për Kriteret dhe Procedurat e Dhënies së Licencave Profesionale të Zbatimit, Klasifikimit dhe Disiplinimit të Subjekteve Juridike, që Ushtrojnë Veprimtari Ndërtimi*” parashikohet se c) Autoritetet kontraktore, në përcaktimin e grafikëve dhe afateve për përfundimin e punimeve të ndërtimit, në dokumentet e tenderit të prokurimit dhe në kontratën e zbatimit të veprave publike, ndërtimore, detyrohen të llogarisin kryerjen e punimeve, për periudhën 22 mars – 23 tetor me 2(dy) turne, për ndërtimin e objekteve në lartësi, dhe me 3(tri) turne, për ndërtimin e rrugëve dhe ndërtimeve të tjera. ç) Autoritetet kontraktore për moszbatimin e kërkesave të përcaktuara në shkronjën “c” dhe për mosndjekjen e zbatimit në këtyre kushteve (kryerjen e punimeve me dy e tri turne), të përcaktuara në kontratën e nënshkruar, ngarkohen me përgjegjësi administrative dhe/ose me përgjegjësi, sipas legjislacionit për prokurimin publik. Sa më sipër, KPP gjykon se në përgjigje të testit të proporcionalitetit të mësipërme, kërkitimi i autoritetit kontraktor mbi disponueshmërinë e dy inxhinierëve gjeodet, parë kjo në raport (proporcion) me kohëzgjatjen e zbatimit të punimeve, vlerën dhe natyrën e punimeve, detyrimin nga akti nënligjor për kryerjen e punimeve në tre turne si edhe kohëzgjatjen maksimale të kohës së punës referuar Kodit të Punës, është një kërkesë në përpjestim me natyrën dhe objektin e punimeve dhe nuk shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme.

III.4.13. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues mbi modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit në drejtim të disponueshmërisë së një inxhinieri agronom, i cili njëherazi duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë, KPP konstaton se referuar shtojcës “*Preventiv i Punimeve*”, autoriteti kontraktor në seksionin KATEGORIA Nr 3: *PUNIME TE NDRYSHME* ka parashikuar kryerjen e punimeve 1 *Mbjellje bari m² 396.03* 2 *F.V.Fidane Peme dekorative cope 20*. KPP gjykon se në hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, në respekt të nenit 46 pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*” të ndryshuar autoriteti kontraktor duhet të parashikojë kriterë kualifikuesë në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës. KPP gjykon se parakushti kyç *sine qua non* për hartimin dhe vendosjen e kriterëve të veçanta të kualifikimit është që këto të fundit të jenë në përputhje me natyrën e kontratës dhe volumin e punimeve. Sa më sipër, KPP gjykon se referuar natyrës së kontratës, volumit të kryerjes së punimeve shfaqet e nevojshme disponueshmëria dhe drejtimi i

punimeve nga një inxhinieri agronom si pjesë e stafit teknik të shoqërisë. Në lidhje me kërkimin e operatorit ekonomik ankimes se inxhinieri agronom nuk mund të jetë pjesë e licencës së zbatimit të punimeve sipas formatit të lëshuar nga MPTT, KPP e gjykon të drejtë pretendimin e këtij të fundit dhe autoriteti kontraktor në lidhje me disponueshmërinë e inxhinierit agronom duhet të parashikojë dorëzimin e licencave në fuqi në përputhje me legjislacionin sektorial.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimese pjesërisht qëndron.

III.4.14. Në lidhje me disponueshmërinë e inxhinierit mekanik, KPP gjykon se në hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, në respekt të nenit 46 pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”* të ndryshuar autoriteti kontraktor duhet të parashikojë kriterë kualifikuese në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës. KPP gjykon se parakushti kyç *sine qua non* për hartimin dhe vendosjen e kriterëve të veçanta të kualifikimit është që këto të fundit të jenë në përputhje me natyrën e kontratës dhe volumin e punimeve. Sa më sipër, KPP gjykon se referuar natyrës së kontratës, volumit të kryerjes së punimeve, llojit të punimeve të kërkuar, si edhe kategorizimit të pikave të licencës, nuk shfaqet e nevojshme disponueshmëria e një inxhinieri mekanik si pjesë e stafit teknik.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimese qëndron.

III.4.15. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes se *“Në këtë kontekst kërkesa juaj që këta drejtues teknik duhet të jenë të pasqyruar në listëpagesat për gjithë periudhën Shkurt 2015- Shkurt 2017 është në kundërshtim të hapur me përcaktimet ligjore që përmenden më lart,Në zbatim të këtyre dispozitave kërkojmë modifikimin e këtij kriteri, duke kërkuar vetëm që drejtuesit teknik të shoqërisë duhet të jenë të përfshirë në listëpagesat e shoqërisë (pra ligjerisht mund të kërkojnë të pasqyrohen në listëpages nga data e nënshkrimit të kontratës së punës).”* Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të drejtë kërkimin e autoritetit kontraktor mbi disponueshmërinë e stafit teknik në listëpagesat e shoqërisë. Referuar kuadrit ligjor në fuqi, *stricta sensu* parashikohet detyrimi i subjekteve juridikë pritvate të deklaramentit të punonjësve (përfshirë edhe stafin teknik kryesor) në listëpagesat e shoqërisë. KPP vlerëson të sqarojë se kërkimi i mësipërm i autoritetit kontraktor lidhet me kërkimin e autoritetit kontraktor mbi dëshmi të fuqisë punëtore të dy viteve të fundit. KPP vlerëson të drejtë pretendimin e operatorit ekonomik ankimes mbi lirinë kontraktuale dhe ndryshimin ndër vite të drejtuesve teknikë dhe në këtë rast, KPP gjykon se në plotësim të synimit të autoritetit kontraktor, operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të dëshmojnë vijueshmëri të marrdhënieve të punësimit me inxhinierët e sipërcituar, duke dorëzuar dëshmi se për periudhën e kërkuar kanë patur vijueshmëri të stafit teknik (inxhinier) sipas profileve sipërcituar, megjithëse këto të fundit mund të jenë të ndryshëm nga inxhinierët që disponojnë të kontraktuar në momentin e dorëzimit të ofertave.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese nuk qëndron.

III.4.16. Në lidhje me kërkimin e operatorit ekonomik ankimues mbi modifikimin e dokumenteve të proedurës së prokurimit objekt ankimi ku parashikohet se *“iv. Te kete ne staf te punesuar dhe te figurojne ne listpagesa per periudhen e kerkuar me eksperience mbi 15- vjet nje inxhinier mjedisi, të paraqitet diploma, kontrata e punës, CV, librezat e punes, certifikata e specialistit leshuar nga Ministria e Mjedisit. (Kjo pike shkon paralelisht me piken 2.1 te kriterreve, pasi qe nje operator te mare licence nga QKL III.2.A duhet te kete ne menyre te domosdoshme inxhinier mjedisi me nje eksperience 15 vjecare dhe te te kete certifikata e specialistit leshuar nga Ministria e Mjedisit)”*, KPP gjykon të drejtë pretendimin e autoritetit kontraktor në lidhje me kërkimin e stafit teknik të kualifikuar duke përfshirë edhe inxhinierin e mjedisit, si një kërkesë në përputhje me nenin 26 pika 8 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, të ndryshuar, por vlerëson se kërkitimi i dëshmi të eksperiencës mbi 15 vjet e inxhinierit të mjedisit, nuk është në përputhje dhe proporcion me objektin e procedurës së prokurimit objekt ankimi. Sa më sipër, KPP vlerëson të drejtë pjesërisht pretendimin e ankimuesit dhe se autoriteti kontraktor duhet të rishikojë vitet e eksperiencës së kërkuar, duke i ulur ato në përputhje dhe proporcion me kontratën objekt prokurimi.

Sa më sipër, pretendimi i palës ankimuese pjesërisht qëndron.

III.4.17. Në lidhje me kërkimin e operatorit ekonomik ankimues mbi modifikimin e dokumenteve të proedurës së prokurimit objekt ankimi ku parashikohet se *“Te kete ne stafin e tij per realizimin e kontrates, dy teknik topograf, nje teknik mekanik, nje teknik hidraulik te shoqeruar me deftesat(diplomat) profesionale dhe kontratat e punes dhe te jene te regjistruar ne kompanine e tij te figurojne ne listpagesa.”* KPP vlerëson se në nenin 26 pika 8 gërma *“a”* dhe *“b”* të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, të ndryshuar, parashikohet se *“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose”* KPP gjykon se referuar, preventivit të punimeve të parashikuar autoriteti kontraktor ka parashikuar ndër të tjera, kryerjen e punimeve si me zëra punimesh si më poshtë vijon:

1: PUNIME NE TRUP TE RRUGES

1 Germim me makineri + transport materiali m³ 10,130.0

2 Germim me krahe seksion detyruar me gjeresi b>1m, h=1.5m, tok e zak m³ 300.0

3 Skarifikim skarpate m² 300.0

4 Shtrese cakell guroreje $t=30\text{cm}$ + cilindrim m^2 25,415.0

5 Shtrese stabilizanti 20cm m^2 25,415.0 6 Shtrese binderi 6cm m^2 20,800.0 TOTALI NO.1

KATEGORIA Nr 2: PUNIME NE VEPRARTI TE VOGLA

1 Tombino me tuba betoni Ø 800, mbi shtrese betoni ml 104.0

2 Kemishe beton M300 m^3 64.0

3 Germim dheu me seksion te detyruar+transport m^3 348.0

KATEGORIA Nr 3: PUNIME TE NDRYSHME

1 Mbjellje bari m^2 396.03

2 F.V.Fidane Peme dekorative cope 20

III.4.17.1. Në lidhje me kërkesën e mësipërme mbi disponueshmërinë e specialistëve të kualifikuar në nivelin e teknikëve, KPP gjykon se referuar natyrës së punimeve parashikuar në preventivin e punimeve shfaqet e nevojshme disponueshmëria e stafit në nivel teknik. Konkretisht KPP vlerëson se kërkimi për një teknik hidraulik shfaqet në përpjestim me përmasat dhe volumin e kontratës për sa kohë që janë parashikuar punime në vepra arti të vogla, pjesë e të cilave janë edhe vendosja e tombino me tuba betoni Ø 800, mbi shtrese betoni ml 104.0, gjithashtu, kërkimi për dy teknik topograf, një teknik mekanik referuar natyrës së punimeve objekt i kontratës së procedurës së prokurimit objekt ankimi shfaqet e nevojshme disponueshmëria e stafit të mësipërm në nivel teknik, ku konkretisht referuar volumit të punimeve topogjeodizike të parashikuar nga autoriteti kontraktor shfaqet nevoja e dy teknikëve topograf, ndërkohë mos prezenca e udhëheqësit teknik (drejtuesit teknik) në nivel inxhinieri mekanik nuk pengon dhe nuk është një herazi një parakusht për mos shfaqjen e nevojës për një teknik mekanik, i rëndësishëm gjatë kryerjes së punimeve.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese nuk qëndron.

III.4.18. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për modifikimin e dokumenteve të tenderit me argumentin se "[...]Në"Kapacitetin teknik", pika 4, është kërkuar në kundërshtim të hapur me kërkesat ligjore: Të kete në stafin e punonjesve të pasqyruar në listepagesa të pakten 30 (tridhjetë) punonjës të pajisur me kartelat personale të sigurimit teknik, të leshuara nga organe kompetente të akredituara në bazë të ligjit nr. 8734, date 01.02.2001 dhe ligjit Nr.13/2013, date 14.02.2013, ku të përfshihen elektriciste, hidraulike, mekanik, saldator). (zhvillimi i punes ka të domosdoshme praninë e punonjesve të kualifikuar në 120 punonjes duhet të jenë të paktën 30 specialist). Ju sjellim ne vemendje se akreditimet qe behen ne baze te ligjit nr. 8734, date 01.02.2001 dhe ligjit Nr.13/2013, date 14.02.2013, dhe kartelat e sigurimit teknik që lëshohen në bazë të këtij ligji, konsistojnë në certifikime për punonjës që do të punojnë në impjante, pajisje dhe instalime elektrike. Edhe vetë testimi që realizohet nga komisioni në baze të këtij ligji bëhet vetëm për punonjes elektrik, të cilët do të punojnë ne tension në impjante, pajisje dhe instalime elektrike. Në kushtet kur në preventivin e këtij objekti nuk është parashikuar asnjë punim elektrik një kërkesë e tillë është e papranueshme. [...]”Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.18.1. Në shtojcën 10 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, “Kapaciteti Teknik”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi është parashikuar se “

Të ketë në stafin e punonjësve të pasqyruar në listepagesa të paktën 30 (tridhjetë) punonjes të pajisur me kartelat personale të sigurimit teknik, të leshuara nga organe kompetente të akredituara në bazë të ligjit nr. 8734, datë 01.02.2001 dhe ligjit Nr.13/2013, datë 14.02.2013, ku të përfshihen elektrikiste, hidraulike, mekanik, saldator). (zhvillimi i punës ka të domosdoshme praninë e punonjësve të kualifikuar në 120 punonjes duhet të jenë të paktën 30 specialist)”

III.4.18.2. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” e ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : “ [...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; [...]”

III.4.18.2. Në nenin 26, pika 8, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

- a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose
- b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose
- c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.

III.4.18.3. Referuar sa më sipër analizuar, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

III.4.18.4. Në interpretim literal të bazës ligjore të sipërcituar Komisioni vlerëson se kriteret e kualifikimit duhet të jenë në përputhje me objektin e prokurimit, natyrën, aftësinë zbatuese, vlerën si dhe përmasat/volumin e kontratës. Referuar relacionit teknik, preventivit dhe projekteve

si dhe kërkesave të autoritetit kontraktor në dokumentat e tenderit vërehet se ky i fundit kërkon të realizojë synimin për rikonstruksionin e aksit rrugor.

III.4.18.5. Në nenin 9 pika 1 gërma “a” të ligjit nr. 8734 datë 01.02.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës të paisjeve dhe instalimeve elektrike”, parashikohet se “Formimi i punëmarrësve” Punëdhënësi merr masat e nevojshme që: a) përdorimi i pajisjeve elektrike të bëhet nga punëmarrës që kanë përgatitje të mjaftueshme, të dokumentuar me dëshmi aftësie, e lëshuar nga IPIE-ja ose nga komisioni i miratuar prej saj”. Në nenin 7 të ligjit nr.13/2013 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8734 datë 01.02.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës të paisjeve dhe instalimeve elektrike”, parashikohet se “Në nenin 9, shkronja “a” e pikës 1 ndryshohet si më poshtë: “a) Përdorimi i pajisjeve elektrike bëhet nga punëmarrës që kanë përgatitje të mjaftueshme, të dokumentuar me dëshmi aftësie, të lëshuar nga një organ i akredituar certifikues personeli për fushën përkatëse.”. Gjithashtu në nenin 5 pika 1 gërma “c” të ligjit nr.116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimi të konformitetit në Republikën e Shqipërisë” parshikohet se “Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit akrediton: c) organe certifikuese të personelit;”. Sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se referuar ndryshimeve të lex specialis ligjit nr. 8734 datë 01.02.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës të paisjeve dhe instalimeve elektrike” me anë të ligjit nr. 13/2013 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8734 datë 01.02.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës të paisjeve dhe instalimeve elektrike”, parashikohet se Përdorimi i pajisjeve elektrike bëhet nga punëmarrës që kanë përgatitje të mjaftueshme, të dokumentuar me dëshmi aftësie, të lëshuar nga një organ i akredituar certifikues personeli për fushën përkatëse.”. Sa më sipër, K.P.P. gjykon se kuadri ligjor në fuqi nuk parashikon mundësinë e certifikimit të punonjësve të subjekteve juridike pranë një organi shtetëror (ish Inspektoritati Qëndror Teknik (IQT), sot Inspektoriat Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI)) por parashikohet se dëshmia e aftësisë mund të lëshohet nga subjekte juridike private, por që plotësojnë kushtin që të jenë të akredituar në përputhje edhe me kuadrin ligjor në fuqi. Akoma më tej, në harmoni me ligjin nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimi të konformitetit në Republikën e Shqipërisë” parshikohet se “Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit akrediton: c) organe certifikuese të personelit;”. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se, referuar kuadrin ligjor në fuqi, subjektet juridike, gëzojnë të drejtën që të trajtojnë/certifikojnë stafin e tyre edhe në subjekt juridikë jo publikë (privatë) ,me kusht që këto të fundit të jenë të certifikuar në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

III.4.18.5. Gjithashtu në dokumentat e tenderit është publikuar dokumentacioni teknik si relacion, projekte etj., si edhe preventivi memec ku konstatohet se ka zëra punimesh të ndara në kapituj si: 1: PUNIME NE TRUP TE RRUGES

1 Germim me makineri + transport materiali m³ 10,130.0

2 Germim me krahe seksion detyruar me gjeresi b>1m, h=1.5m, tok e zak m³ 300.0

3 Skarifikim skarpate m² 300.0

4 Shtrese cakell guroreje t=30cm + cilindrim m² 25,415.0

5 Shtrese stabilizanti 20cm m² 25,415.0 6 Shtrese binderi 6cm m² 20,800.0 TOTALI NO.1

KATEGORIA Nr 2: PUNIME NE VEPRAT ARTI TE VOGLA

1 Tombino me tuba betoni Ø 800, mbi shtrese betoni ml 104.0

2 Kemishe beton M300 m³ 64.0

3 Germim dheu me seksion te detyruar+transport m³ 348.0

KATEGORIA Nr 3: PUNIME TE NDRYSHME

1 Mbjellje bari m² 396.03

2 F.V.Fidane Peme dekorative cope 20

[...]"

III.4.18.7. Në lidhje me kundërshtimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues, mbi modifikimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit për procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është me vend të ndalet në një test balancues të dy elementëve kryesorë. Së pari nëse kërkesa në fjalë është të përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti nëse kërkesa në fjalë shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. Gjithashtu, në shqyrtimin e kriterit të mësipërm të kualifikimit, K.P.P. gjykon të ndalet edhe në faktin në rast se kriteri i mësipërm është në proporcion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 46 pika 1 të LPP-së.

III.4.18.8. Sa më sipër, KPP gjykon se qëllimi kryesor i autoritetit kontraktor është kryerja e punimeve të kontratës objekt prokurimi në përputhje me cilësinë e kërkuar dhe nga staf teknik i kualifikuar. Për arritjen e këtij synimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar disponueshmërinë e stafit teknik të kualifikuar me IQT. Në lidhje me numrin e punonjësve të kërkuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kërkimi prej 30 punonjësish nuk është në përputhje me natyrën e punimeve të kontratës objekt prokurimi. Sa më sipër, KPP gjykon se në modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit autoriteti kontraktor duhet të mbajë në konsideratë se referuar kuadrit ligjor në fuqi, veçanërisht nenit 91 gërma "a" të ligjit nr. 8734 datë 01.02.2001 "Për garantimin e sigurisë së punës të paisjeve dhe instalimeve elektrike", parashikohet se punëdhënësit detyrohen të certifikojnë pranë subjekteve të akredituara (më parë IQT) në drejtim të formimit profesional të punonëmarrësve për përdorimin e paisjeve si më poshtë vijon: "Punëdhënësi merr masat e nevojshme që:a) përdorimi i paisjeve elektrike të bëhet nga punëmarrës që kanë përgatitje të mjaftueshme, të dokumentuar me dëshmi aftësie, e lëshuar nga IPIE-ja ose nga komisioni i miratuar prej saj", si edhe volumit të punimeve respektive për të cilat shfaqet e nevojshme kualifikimi i sipërcituar.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese qëndron.

III.4.19. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues mbi ndryshimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi në drejtim të kriterëve të veçanta të kualifikimit ku parashikohet se "vi. Per gjithë drejtuesit e makinerive te renda , sipas Urdher

Nr.44, datë 4.2.2004 “Per miratimin e rregullores “Per Procedurat dhe kriteret per dhenien e lejeve te manovrimit perdoruesve te makinerive te renda te ndertimit dhe disiplinimi i perdorimit te makinerive te ndertimit” Deshmi te aftesise profesionale ose leje manovrimi te vlefshme leshuar nga Ministria e Transportit dhe Infrastruktures te vlefshme, minimumi 5 automakinista, 1 eskavatorist me zinxhir, 2 eskavatorist me goma, 2 buldozerist te shoqeruar me kontratat e punes dhe të figurojne ne listpagesa.” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.19.1. Referuar shtojcës 10, kriterëve të veçanta të kualifikimit, autoriteti kontraktor ndër të tjera ka parashikuar disponueshmërinë e mjeve të nevojshme për zbatimin e punimeve si më poshtë vijon:

Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamionvetëshkarkues (kapaciteti mbi 15 ton)	7 copë	Pronësi ose me qera
Kamioncine veteshkarkuese 1.4-2 ton	4 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma	2copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me zinxhir	2copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me krahtegjate me akses 18 m	1copë	Pronësi ose me qera
Bobcat	1copë	Pronësi ose me qera
Minieskavator	1copë	Pronësi ose me qera
Rul ngjeshes kapaciteti minimal 17 ton	2copë	Pronësi ose me qera
Rrul per shtresat kapaciteti 4 ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Rul ngjeshes kapaciteti minimal 12 ton	2 copë	Pronësi ose me qera
AutobotUji	2 copë	Pronësi ose me qera
Fabrike asfalti ose mobile	1copë	Pronësi , qera ose me kontrate furnizimi
Autobot Nafte	1 copë	Pronësi ose me qera

Rimorkiator	1 copë	Pronësi ose me qera
Gjeneratore 120këa	1copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	1copë	Pronësi ose me qera
Autopompe	1copë	Pronësi ose me qera
Tabela Rrugore+ Semafore per bllokimin ne rruge	4 copë	Pronësi ose me qera
Cekic pneumatik me maje cpuese	1copë	Pronësi ose me qera
Kompresor ajri monofaze 100 cm2	1 copë	Pronësi ose me qera
Vibrator elektrik siperfaqesor	2 copë	<i>Pronësi ose me qera</i>
Kompator ngjeshes nen 1 ton	3 copë	<i>Pronësi ose me qera</i>

III.4.19.2. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”*

III.4.19.3. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.4.19.4. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kualifikimi dhe lëshimi i dëshmisë përkatëse për punonjësit për drejtimin e mjeteve të rënda (manovratorë) rregullohet në mënyrë specifike nga akti nënligjor, Vendimit nr.808 datë 04.12.2003 i Këshillit të Ministrave “Për dhënien e

lejeve të manovrimit të përdoruesve të makinerive të rënda të ndërtimit”, i ndryshuar. Në pikën 1 të Vendimit nr.808 datë 04.12.2003 i Këshillit të Ministrave “Për dhënien e lejeve të manovrimit të përdoruesve të makinerive të rënda të ndërtimit”, i ndryshuar parashikohet se *“Personi fizik, qe ushtron profesionin e manovruesit te makinerive te renda te ndërtimit, duhet te jete i pajisur me dëshmi aftësimi”*. Gjithashtu, me anë të URDHËR Nr. 109, datë 5.8.2013 Për Miratimin E Rregullores “Për Kushtet, Kriteret Dhe Programet Për Përgatitjen Teorike-Praktike Të Kandidatëve, Si Dhe Dhënien E Dëshmisë Së Aftësisë Profesionale Për Përdoruesit E Makinerive Të Rënda Për Punime Ndërtimi Dhe Toke, Si Dhe Disiplinimi I Përdorimit Të Makinerive Të Ndërtimit” është miratuar edhe “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teorikepraktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit”.

III.4.19.5. Referuar nenit 7 të Rregullores së mësipërme parashikohet se “Makineritë e rënda të ndërtimit dhe emërtimet bëhen sipas dëshmive të aftësive profesionale (DAP), të cilat ndahen si më poshtë:

a) makineri gërmimi e ngarkimi dherash: vetëshkarkues, ngarkues-transportues, ekskavatorë, fadroma, ekskavatorë të kombinuar me pajisje shtesë, lopata ngarkuese (me goma dhe me zinxhirë), manovratorëve u jepet dëshmi për ekskavatoristë (për mjete me goma ose me zinxhirë);

b) makineri gërmimi, shtyrje, nivelimi e ngjeshje dherash apo shpim toke: buldozerë, traktorë, skreper, greidera (nivelues), rulo vibruës, shtruese asfalto-betoni, sonda shpimi vetëlëvizëse, manovratorëve u jepet dëshmi për buldozeristë (me goma ose me zinxhirë);

c) makineri ndërtimi mbi bazë automjeti: autovinça, autobetoniere, autobetonpompa, autobitumatrine, autosonda, manovratorëve u jepet dëshmi për automakinistë.

2. Përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit me rrota gome, përpara se të marrin dëshminë e aftësisë profesionale, duhet të jenë pajisur detyrimisht edhe me leje drejtimi automjetesh të lëshuar nga DPSHTRR-ja, konform nenit 122 të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor I Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”

III.4.19.6. Lidhur me kundërshtimet e operatorit ekonomik ankimues, KPP gjykon të drejtë pretendimin e këtij të fundit mbi saktësimin e bazës ligjore mbi kërkimin e Dëshmive të Aftësimi Profesional dhe autoriteti kontraktor duhet të parashikojë në kriteret e veçanta të kualifikimit bazën e saktë ligjore në fuqi në lidhje me certifikimin e punonjësve me Dëshmi Aftësimi Profesional. Në lidhje me kërkimin e dytë të operatorit ekonomik ankimues, në të cilin, ky i fundit parashtron argumente duke kundërshtuar kërkesën e autoritetit kontraktor në lidhje me numrin dhe natyrën e dëshmive të kërkuara KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka parashikuar ndër të tjera disponueshmërinë e 5 automakinista, ndërkohë referuar kriterëve të veçanta të kualifikimit, konstatohet se është kërkuar disponueshmëria e automakinerve të

ndryshme si automakeri ngarkues-transportues (kamiona), automakeri niveluese, rulvibrues, etij, të cilat në total e tejkalojnë disa herë numrin 5 të automakinistave të kërkuar. KPP gjykon se referuar pikës 2 të nenit 7 të rregullores së mësipërme parashikohet se, *“Përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit me rrota gome, përpara se të marrin dëshminë e aftësisë profesionale, duhet të jenë pajisur detyrimisht edhe me leje drejtimi automjetesh të lëshuar nga DPSHTRR-ja, konform nenit 122 të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor I Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”* Sa më sipër, KPP gjykon se në interpretim të bazës ligjore së mësipërme, disponueshmëria e patentës sipas klasave të ndryshme nuk pengon certifikimin e automakinistëve me DAP dhe kërkesa e mësipërme është në përputhje dhe proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës. Gjithashtu, KPP gjykon të drejtë kërkimin e autoritetit kontraktor mbi disponueshmërinë e operatorëve ekonomikë në stafin e tyre teknik të certifikuar me DAP të një , *1 eskavatorist me zinxhir, 2 eskavatorist me goma*, si një kriter në përputhje dhe proporcion me natyrën dhe objektin e prokurimit, për sa kohë që referuar kapacitetit teknik është parashikuar disponueshmëria e eksavatorëve me goma dhe me zinxhirë dhe se drejtimi i tyre mund të kryhet vetëm nga punonjës të kualifikuar. Ndërkohë në lidhje me kërkimin për dy buldozeristë, KPP konstaton se referuar listës së makinerive të kërkuara të disponueshme për realizimin e kontratës, nuk është parashikuar disponueshmëria e mjetit tip *buldozer* dhe sa më sipër, kriteri nuk është në përputhje dhe proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës objekt prokurimi. Gjithashtu, KPP vlerëson të drejtë kërkesën e autoritetit kontraktor se stafi i mësipërm duhet të jetë pjesë e stafit të shoqërisë në respekt të nenit 26 pika 8 të aktit nënligjor në zbatim të ligjit VKM 914/2014.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese pjesërisht qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik për rishikimin e mjeteve të kërkuara Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.5.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 10 *Kriteret e veçanta të Kualifikimit* . është kërkuar:

Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (shtojca 9)

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
<i>Kamionvetëshkarkues (kapaciteti mbi 15 ton)</i>	<i>7 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Kamioncine veteshkarkuese 1.4-2 ton</i>	<i>4 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>

<i>Eskavator me goma</i>	<i>2copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Eskavator me zinxhir</i>	<i>2copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Eskavator me krahtegjate me akses 18 m</i>	<i>1copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Bobcat</i>	<i>1copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Minieskavator</i>	<i>1copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Rul ngjeshes kapaciteti minimal 17 ton</i>	<i>2copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Rrul per shtresat kapaciteti 4 ton</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Rul ngjeshes kapaciteti minimal 12 ton</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>AutobotUji</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Fabrike asfalti ose mobile</i>	<i>1copë</i>	<i>Pronësi , qera ose me kontrate furnizimi</i>
<i>Autobot Naftë</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Rimorkiator</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Gjeneratore 120këa</i>	<i>1copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Autobetoniere</i>	<i>1copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Autopompe</i>	<i>1copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Tabela Rrugore+ Semafore per bllokimin ne rruge</i>	<i>4 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Cekic pneumatik me maje cpuese</i>	<i>1copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Kompresor ajri monofaze 100 cm2</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Vibrator elektrik sipërfaqësor</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Kompator ngjeshes nen 1 ton</i>	<i>3 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>

- Kokore minimumi 30 cope

- *Rripa lidhes sigurimi per punime ne lartesi minimumi 5 cope*
- *Fikse zjarri te levizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 3 cope*
- *Prozhektore ndricimi naten minimumi 4 cope*
- *Komplet i ndihmes se shpejte minimumi 5 cope*
- *Tabela paralajmeruese per sigurine ne objekt minimumi 20 cope*

III.5.2. Në sistemin e prokurimeve elektronike nga autoriteti kontraktor krahas dokumentave të tenderit janë publikuar specifikimet teknike si dhe preventivi me zërat e punëve që do të kryhen.

III.5.3. Në nenin 26, pika 8, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet:

“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

- a) *licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose*
- b) *dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
- c) *dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.*

III.5.4. Referuar Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 1, pika 2 përcaktohet:

- c) *të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) *të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*

III.5.5. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike (makineritë), në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentat e tenderit.

III.5.6. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues mbi modifikimin e numrit të kamionëve me argumentin se : *“Përsa i perket kamionave na duket tepër e ekzagjeruar kërkesa për 7 kamiona mbi 15 ton, duke ditur gjerësinë e ngushte të rrugës dhe volume normale gjurmuese dhe mbushëse 7 kamiona në këtë rrugë do të krijojnë një kaos të madh në trafik duke ditur që ajo është edhe një rrugë në shfrytëzim”* si edhe 4 kamionçinave , si edhe

disponueshmërisë së dy autobotëve të ujit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se referuar preventivit të punimeve të kontratës së prokurimit objekt ankimi, ndër të tjera autoriteti kontraktor ka kërkaur ndër të tjera edhe kryerjen e punimeve si më poshtë vijon: *Germim me makineri + transport materiali m³ 10,130.0 ;2 Germim me krahe seksion detyruar me gjerësi b>1m, h=1.5m, tok e zak m³ 300.0 ;3 Skarifikim skarpate m² 300.0;4 Shtrese cakell guroreje t=30cm + cilindrim m² 25,415.0;5 Shtrese stabilizanti 20cm m² 25,415.0 6 Shtrese binderi 6cm m² 20,800.0 TOTALI NO.1.* Në Kreun III “*Kategorizimi Dhe Klasifikimi I Licencës, Elementet E Saj, Kushtet, Kriteret Dhe Kufizimet*” të Vendimin nr.42 të Këshillit të Ministrave datë 16.01.2008 “*Për Miratimin e Rregullores për Kriteret dhe Procedurat e Dhënies së Licencave Profesionale të Zbatimit, Klasifikimit dhe Disiplinimit të Subjekteve Juridike, që Ushtrjnë Veprimtari Ndërtimi*” parashikohet se c) Autoritetet kontraktore, në përcaktimin e grafikëve dhe afateve për përfundimin e punimeve të ndërtimit, në dokumentet e tenderit të prokurimit dhe në kontratën e zbatimit të veprave publike, ndërtimore, detyrohen të llogarisin kryerjen e punimeve, për periudhën 22 mars – 23 tetor me 2(dy) turne, për ndërtimin e objekteve në lartësi, dhe me 3(tri) turne, për ndërtimin e rrugëve dhe ndërtimeve të tjera. ç) Autoritetet kontraktore për moszbatimin e kërkesave të përcaktuara në shkronjën “c” dhe për mosndjekjen e zbatimit në këtyre kushteve (kryerjen e punimeve me dy e tri turne), të përcaktuara në kontratën e nënshkruar, ngarkohen me përgjegjësi administrative dhe/ose me përgjegjësi, sipas legjislacionit të prokurimit publik. Sa më sipër, KPP gjykon se referuar natyës dhe objektit të punimeve, volumit të punimeve, transportin e materialeve në sasi të parashikuara m³ 10,130.0, Sa më sipër, parë në raport me volumin e punimeve, detyrimin e kryerjes së punimeve me tre turne dhe kohëzgjatjes së parashikuara për realizimin e punimeve gjithësej 60 ditë, KPP vlerëson të drejtë kërkesën e autoritetit kontraktor për disponueshmërinë e 7 kamionëve dhe 4 kamionçinave dhe dy autobotëve të ujit.

III.5.7. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues mbi modifikimin e numrit të eksavatorëve, rulave, rulave ngjeshës, kompatatorit dhe minieskavatorit bobcat Komisioni i Prokurimit Publik vëren se referuar preventivit të punimeve të kontratës së prokurimit objekt ankimi, ndër të tjera autoriteti kontraktor ka kërkaur ndër të tjera edhe kryerjen e punimeve si më poshtë vijon: *Germim me makineri + transport materiali m³ 10,130.0 ;2 Germim me krahe seksion detyruar me gjerësi b>1m, h=1.5m, tok e zak m³ 300.0 ;3 Skarifikim skarpate m² 300.0;4 Shtrese cakell guroreje t=30cm + cilindrim m² 25,415.0;5 Shtrese stabilizanti 20cm m² 25,415.0 6 Shtrese binderi 6cm m² 20,800.0 TOTALI NO.1.* Në Kreun III “*Kategorizimi Dhe Klasifikimi I Licencës, Elementet E Saj, Kushtet, Kriteret Dhe Kufizimet*” të Vendimin nr.42 të Këshillit të Ministrave datë 16.01.2008 “*Për Miratimin e Rregullores për Kriteret dhe Procedurat e Dhënies së Licencave Profesionale të Zbatimit, Klasifikimit dhe Disiplinimit të Subjekteve Juridike, që Ushtrjnë Veprimtari Ndërtimi*” parashikohet se c) Autoritetet kontraktore, në përcaktimin e grafikëve dhe afateve për përfundimin e punimeve të ndërtimit, në dokumentet e tenderit të prokurimit dhe në kontratën e zbatimit të veprave publike, ndërtimore, detyrohen të llogarisin kryerjen e punimeve, për periudhën 22 mars – 23 tetor me 2(dy) turne, për ndërtimin e

objekteve në lartësi, dhe me 3(tri) turne, për ndërtimin e rrugëve dhe ndërtimeve të tjera. ç) Autoritetet kontraktore për moszbatimin e kërkesave të përcaktuara në shkronjën “c” dhe për mosndjekjen e zbatimit të këtyre kushteve (kryerjen e punimeve me dy e tri turne), të përcaktuara në kontratën e nënshkruar, ngarkohen me përgjegjësi administrative dhe/ose me përgjegjësi, sipas legjislacionit për prokurimin publik. Sa më sipër, KPP gjykon se referuar natyës dhe objektit të punimeve, volumit të punimeve, , detyrimin e kryerjes së punimeve me tre turne dhe kohëzgjatjes së parashikuar për realizimin e punimeve gjithësej 60 ditë, KPP vlerëson të drejtë kërkesën e autoritetit kontraktor për disponueshmërinë e mjeteve të mësipërme me synim realizimin e kontratës.

III.5.8. Gjithashtu edhe në lidhje me autobotët e naftës, referuar mjeteve të kërkuara nga autoriteti kontraktor, punëve që do të kryhen si edhe specifikës së objektit të kontratës dhe afatit kohor për kryerjen e punëve, KPP gjykon se përcaktimi i një mjeti të tillë është i domosdoshëm në mënyrë që mjetet të jenë të furnizuara në çdo moment, pa qenë të varur nga pikat e karburantit që mund të ndodhen në atë segment rrugor, me qëllim mos krijimin e pengesës për realizimin në kohë të objektit të kontratës. Akoma më tej, KPP vlerëson se pjesë e mjeteve të kërkuar si të disponueshme janë edhe mjete kantieri *eksavatorë me zinxhirë*, të cilët nuk mund të lëvizin dot pa ndihmën e mjeteve të tjera (rimorkio dhe tërheqës) e sa më sipër, gjatë kryerjes së punimeve, furnizimi i tyre nuk mund të kryhet në pikat e pretenduara të furnizimit me lëndë djegëse (karburant) nga ankimuesi.

III.5.9. Në lidhje me pretendimin mbi autopompën e betonit, KPP konstaton se në seksionin 3 të Shtojcës mbi Specifikimet Teknike, pjesë e dokumenteve të procedurës së prokurimit, parashikohet se

3. *Transporti dhe hedhja e betonit në vepër.*

(a) **TRANSPORTIMI I BETONIT**

Betoni duhet të leviz nga vendi i perzierjes deri në vendin e hedhjes në vepër sa më shpejtë që të jete e mundur me mjete që parandalojnë ndarjen në shtresa humbjen perberesve ose ndotjen .

Kur është e mundur betoni do të shkarkohet nga perzieresi direkt në objekt ose sa më afër të jete e mundur vendit përfundimtar për të shmangur rrjedhjen. (b) HEDHJA DHE NGJESHJA E BETONIT Betoni nuk duhet të hidhet pa miratimin e Inxhinierit. Ngjeshja e betonit duhet të konsiderohet si punimi me i rëndësishëm ,objekt i të cilit është prodhimi i një betoni me densitet dhe fortesi maksimale. Betoni do të ngjishet teresisht me ane të vibrimit gjatë operacionit të hedhjes dhe do të punohet teresisht përreth perforcimit dhe çdo pajisje tjetër si edhe në qoshet e armatures . Betoni nuk do të hidhet në vend nga një lartësi që i kalon 2 m. Nëse betoni nuk fillohet 24 orësh nga dhenia e lejes atëherë duhet të meret leje perseri. Betonimi do të vazhdojë në të gjithë zonën ndërmjet nyjeve të ndërtimit . Betoni i fresket nuk duhet të vendoset mbi një shtresë tjetër betoni që ka qenë hedhur para më shumë se 30 min. Kur betoni I mëparshëm ka qenë hedhur para 4 orësh mbi të nuk mund të vendoset beton tjetër për 20 ore të tjera . Kur hidhet betoni duhet të ketë një temperaturë midis 5° C dhe 38°C . Betoni do të ngjishet në

pozicionin e tij perfundimtar brenda 30 min nga shkarkimi prej perzieresit pervec se kur eshte transportuar me ane te pajisjeve te vecanta qe punojne vazhdimisht , kur koha do te jete brenda 2 oresh nga futja e cimentos ne perzierje dhe brenda 30 min nga shkarkimi. Betoni do te depozitohet ne shtresa horizontale ne nje thellesi kompakte qe nuk kalon nga 450 mm ne rastin e perdorimit te vibratoreve te brendshem . Thellesia e njesise qe do te betonohet do te percaktohet nga Kontraktuesi dhe miratohen nga Inxhinieri.... [...]” Sa më sipër, KPP vlerëson se referuar metodës së punës për transportimin dhe hedhjen e betonit, shfaqet e nevojshme disponueshmëria e mjetit tip autopombë betoni.

III.5.10. Përsa i përket pretendimit të operatorit ekonomik në lidhje me pretendimin se “Kërkojmë të hiqet kërkesa për Tabela Rrugore+ Semafore për bllokimin ne rruge 4cope sepse nuk mund të vendosesh me shume se dy te tille një në fillim të rrugës dhe një në fund të rrugës” Në shtojcën mbi “Specifikimet Teknike” të procedurës së prokurimit objekt ankimi ndër të tjera është parashikuar se Sipërmarrësi duhet te vendose tabelat provizore gjatë kryerjes së punimeve e vendosjen e tabelave e shenjave përfundimtare. Ato duhet të jenë vendosur në mënyrë të tillë që të shihen mire nga përdoruesit e mjeteve dhe të marrin parasysh skemën e qarkullimit” KPP vlerëson se kërkitimi i paisjeve të mësipërme nga ana e autoritetit kontraktor lidhet drejtpërdrejtë me sigurinë në kantierin e punimeve. Parë në raport me volumin e punimeve, gjatësisë së segmentit rrugor, kompleksitetit të punimeve dhe nivelit të qarkullueshmërisë në aksin rrugor, KPP vlerëson të drejtë kërkesën e mësipërme nga ana e autoritetit kontraktor në lidhje me tabelat paralajmëruese.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese nuk qëndron

Në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri:

Vendos

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Mane/S” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me objekt “Rikonstruksion dhe shtrim i rruges bujqesore te fushes se fshatit Pal” me nr. Ref 71229-03-09-2017 me fond limit 76,573,764 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 31.03.2017 nga autoriteti kontraktor Bashkia Sarandë.
2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Mane/S” sh.p.k.

5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 584 Protokolli; Datë 27.03.2017

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Kleves Janku

Anëtar
Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha

